

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6012
E premte, 28 shkurt 2020
çmimi 0.40 €

FLET PËR "EPOKËN E RE", NASER RAMADANI

Nuk ka vend për panik, kemi marrë masa për koronavirusin



FAQE 4-5

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

VRITET NË MËNYRË MISTERIOZE LUFTËTARI I ORËVE TË PARA TË UÇK-së, QERIM KELMENDI



Në orët e para të mëngjesit të ditës së enjte, ish-luftëtar i UÇK-së, Qerim Kelmendi nga fshati Llabjan i Pejës, është gjetur i vdekur brenda veturës së tij e cila ishte djegur. Sektori Rajonal i Hetimeve pranë Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë ka njoftuar se në bashkëpunim të plotë me Prokurorin e Shtetit janë duke u marrë të gjitha veprimet hetimore për t'i sqaruar rrethanat e këtij rasti të cilësuar 'vrasje'. Për vrasjen e Qerim Kelmendit kanë reaguar përfaqësuesit e institucioneve të vendit, presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Albin Kurti, liderë partish, kryetarë komunash, OVLUÇK-ja dhe bashkëluftëtarë të Qerim Kelmendit, të cilët e kanë cilësuar vrasje mizore. Ata u kanë bërë thirrje organeve të drejtësisë që sa më shpejt ta zbardhin këtë rast

FAQE 7



Qeveria Kurti nga 15 marsi heq pjesërisht tarifën ndaj Serbisë dhe Bosnjës

Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që tarifa për lëndën e parë që vjen në Kosovë nga Serbia dhe Bosnja të hiqet nga data 15 mars. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë për media ka thënë të enjten se pas takimeve me

odat dhe shoqatat e ndryshme të ndërmarrësve vendorë dhe pas analizës, ka vendosur që nga data 15 mars të hiqet taksa për lëndën e parë që importohet nga Serbia dhe Bosnja. Ai ka thënë se nëse pala serbe dëshmon përkushtimin për

ndalimin e fushatës jomiqësore ndaj Kosovës dhe zotohet për heqje të shpejtë të barrierave tregtare jotarifore atëherë, duke filluar nga data 1 prill, Qeveria e Kosovës do ta heqë tërësisht tarifën për një periudhë prej 90 ditësh

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SPORT
**SELIMI: PRISHTINA
KA PËRPARËSI TERRENIN
DHE TRADITËN** F. 16

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Komandanti i KFOR-it rithekson rëndësinë e vazhdimet të dialogut Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri Haki Abazi, kanë pritur të enjten në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Michele Risi, i shoqëruar prej asistentit të tij ushtarak, kolonellejtënant Dario Paduano, dhe këshilltarit të tij politik, Alexander Aalmo. “Në një atmosferë shumë miqësore u rikonfirmua përkushtimi për bashkëpunim të afërt ndërmjet kryeministrit

dhe komandantit të KFOR-it, përbrenda mandateve që kanë. Kryeministri shprehu falënderimin në emër të qytetarëve të Kosovës për rolin e vazhdueshëm të KFOR-it në sigurimin e paqes dhe stabilitetit në gjithë territorin e Kosovës. Po ashtu, ai vuri theksin në qëllimin e integritetit të Kosovës në NATO si aspiratë që do të realizohet domosdoshmërisht në të ardhmen. Në këtë fazë, bashkëpunimi i KFOR-it me Ministrinë e Mbrojtjes është i

një rëndësie të veçantë”, është bërë me dije në njoftimin e Qeverisë së Kosovës. Sipas këtij njoftimi, komandanti i KFOR-it ka theksuar se nën mandatin e tij të OKB-së, KFOR-i do t'i vazhdojë përpjekjet e tij për të ofruar një mjedis të qetë dhe të sigurt dhe liri të lëvizjes për të gjithë njerëzit e Kosovës. “Ai, gjithashtu, ritheksoi rëndësinë e vazhdimet të dialogut Kosovë-Serbi, si dhe angazhimit për koordinim institucional në interes të sig-

urisë në Kosovë. Më pas, komandanti i KFOR-it e njoftoi kryeministrin se, nën mandatin e KFOR-it, dhe në kuadër të përgjegjësisë të menaxhimit të hapësirës ajrore të autoriteteve të NATO-s, me ndihmën e Hungarisë dhe Islandës, po vazhdojnë përpjekjet për hapjen e korridoreve të reja ajrore. Në fund të takimit, bashkëbiseduesit shprehën edhe një herë gatishmërinë për derë të hapur për komunikim dhe bashkëpunim të vazh-



dueshëm. Komandanti i KFOR-it i dorëzoi kryeministrit Stemen e Komandantit të KFOR-it”, është thënë në njoftimin e Qeverisë.

Kryeministri Albin Kurti mban konferencë për media

Qeveria Kurti nga 15 marsi heq pjesërisht tarifën ndaj Serbisë dhe Bosnjës

Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që tarifa për lëndën e parë që vjen në Kosovë nga Serbia dhe Bosnja të hiqet nga data 15 mars. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë për media ka thënë të enjten se pas takimeve me odat dhe shoqatat e ndryshme të ndërmarrësve vendorë dhe pas analizës, ka vendosur që nga data 15 mars të hiqet taksa për lëndën e parë që importohet nga Serbia dhe Bosnja. Ai ka thënë se nëse pala serbe dëshmon përkushtimin për ndalimin e fushatës jomiqësore ndaj Kosovës dhe zotohet për heqje të shpejtë të barrierave tregtare jotarifore atëherë, duke filluar nga data 1 prill, Qeveria e Kosovës do ta heqë tërësisht tarifën për një periudhë prej 90 ditësh.



PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Qeveria e Kosovës gjatë javës së ardhshme do të marrë vendim që nga data 15 mars të hiqet tarifa për lëndën e parë që importohet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Këtë e ka konfirmuar të enjten kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë për media. Ai u ka bërë ftesë autoriteteve të Serbisë që si përgjigje ndaj vendimit të palës së Kosovës të zotohet se do ta ndërpresë fushatën për çnjohjen e pavarësisë së Kosovës si dhe ta nisë eliminimin e barrierave tregtare jotarifore ndaj Kosovës.

Siç ka thënë Kurti, nëse pala serbe dëshmon përkushtimin për ndalimin e fushatës jomiqësore ndaj Kosovës dhe zotohet për heqje të shpejtë të barrierave tregtare jotarifore atëherë, duke filluar nga data 1 prill 2020, Qeveria e Kosovës do ta heqë tërësisht tarifën për importet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina për një periudhë prej 90 ditësh. Kryeministri Kurti ka pohuar se nëse Serbia nuk reflekton në këtë drejtim, atëherë tarifa 100 për qind do të rikthehet përsëri më 15 qershor. “Nëse pala serbe nuk reflekton përsëri, atëherë Qeveria

e Kosovës me fillim nga data 15 qershor do ta rikthejë tarifën përsëri. Reciprociteti i plotë tregtar instalohet pas 15 qershorit”, ka deklaruar Kurti, i cili ka pohuar se për këtë vendim është njoftuar edhe partnerja qeverisëse, LDK-ja. “Unë kam pasur një takim me zëvendëskryeministrin Hoti dhe e kam njoftuar në vija të trasha për heqjen e tarifës për lëndën e parë dhe reciprocitetin në anën tjetër”, ka thënë ai. Kryeministri Kurti ka theksuar se Bashkimi Evropian duhet ta vlerësojë lart vendimin e palës së Kosovës për heqjen e tarifës 100

për qind ndaj prodhimeve të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës, duke e ofruar liberalizimin e vizave para Samitit të Zagrebit, që do të mbahet më 7 maj 2020. Kurti ka shtuar që në rast se Serbia nuk e përfillë vullnetin e mirë të Qeverisë së Kosovës për eliminimin e barrierave tregtare, ekonomike dhe politike në raportet e ndërsjella dhe për pasojë, nuk e pushon fushatën jomiqësore në rrafshin ndërkombëtar dhe nuk fillon heqjen e barrierave në marrëdhëniet me Kosovën, “atëherë, Qeveria e Kosovës, me fillim nga data 1 prill do ta nisë

implementimin gradual të principit të reciprocitetit, njëherë në fushën e tregtisë, më pastaj edhe në fushën ekonomike dhe atë politike”. Tarifa prej 100 përqindësh ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës është vendosur në nëntor të vitit 2018 nga Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga ish-kryeministri Ramush Haradinaj, si kundërpërgjigje, siç është thënë, ndaj fushatës agresive diplomatike të Serbisë për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, si dhe për tërheqjen e njohjeve të saj.

Në Tiranë po mbahet konferenca ndërkombëtare për sigurinë rrugore, pjesë e saj edhe Policia e Kosovës

Prishtinë, 27 shkurt (ER) - Në konferencën ndërkombëtare për sigurinë rrugore e cila po mbahet në Tiranë, po marrin pjesë përfaqësues të niveleve të larta nga Shqipëria dhe nga vende të ndryshme të botës, përfshirë edhe përfaqësues të lartë nga Policia e Kosovës (PK). Viti 2020 është shpallur “Viti i sigurisë rrugore” në Shqipëri dhe përmes kësaj konference ndërkombëtare synohet për-

mirësimi i vazhdueshëm i perimetrave të sigurisë rrugore, përmes ndryshimeve të nevojshme dhe hartimit të projekteve të rëndësishme që ndikojnë në ngritjen e nivelit të sigurisë rrugore. Një kontribut të veçantë në këtë drejtim ka dhënë edhe Policia e Kosovës përmes bashkëpunimit të ndërsjellë, shkëmbimit të përvojave trajnuese dhe patrullimeve të përbashkëta policore

në Shqipëri. Policia e Kosovës vazhdon ta ketë ndër prioritetet kryesore sigurinë në trafikun rrugor, ku në Planin Zhvillimor Strategjik 2016-2020, sigurinë e ka të përfshirë në objektivin e parë strategjik, “ofrimi i sigurisë publike dhe forcimi i besimit të qytetarëve”, konkretisht në objektivin e dytë specifik “ngritja e nivelit të sigurisë në trafikun rrugor dhe parandalimi i aksi-

denteve”. Po ashtu, Policia e Kosovës objektivat e veta strategjike i ka të harmonizuara edhe me strategjitë e qeverisë dhe institucioneve të tjera që kanë të bëjnë me fushën e trafikut, përmes të cilave synohet ngritja e mëtejme e nivelit të sigurisë rrugore. Në këtë konferencë ndërkombëtare u zotua për bashkëpunim të gjerë ndërmjet institucioneve dhe agjencive pjesëmarrëse.



Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, është pritur në takim nga sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, në kuadër të vizitës zyrtare në Uashington

Pompeo kërkon heqjen e taksës ndaj mallrave serbe

Sekretari Amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, ka pritur në takim presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, i cili po qëndron për vizitë zyrtare në Uashington. Pompeo i ka bërë thirrje Kosovës që ta heqë taksën ndaj mallrave serbe, duke rikonfirmuar në këtë takim me Thaçin partneritetin e fortë mes ShBA-së dhe Kosovës dhe mbështetjen për një Kosovë të pavarur dhe sovranë



EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

UASHINGTON, 27 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, ka thënë se pret që Kosova ta heqë taksën ndaj mallrave serbe. Sipas njoftimit të zëdhënësës së Departamentit të Shtetit, Morgan Ortagus, gjatë takimit me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën, sekretari Pompeo i bëri thirrje Kosovës ta shfrytëzojë momentin e krijuar pas nënshkrimit të dokumenteve që synojnë krijimin e lidhjeve ajrore, hekurudhore dhe tokësore midis Prishtinës dhe Beogradit. Sekretari Pompeo, sipas zëdhënësës, “pret që Kosova t’i heqë tarifat ndaj mallrave serbe, në mënyrë që popujt e të dy vendeve t’i kenë përfitimet maksimale ekonomike dhe tregtare, një hap ky jetik për t’i rifilluar bisedimet për normalizimin e përgjithshëm të marrëdhënieve”. Sekretari i Shtetit, sipas zëdhënësës, ripohoi partneritetin e fortë mes Shteteve të Bashkuara

dhe Kosovës dhe mbështetjen për një Kosovë të pavarur dhe sovranë.

Pompeo ka përsëritur zgjedhjet e fundit dhe formimin e qeverisë së re, duke theksuar rëndësinë e sundimit të ligjit dhe zhvillimit ekonomik për begatinë e Kosovës.

Sekretari Pompeo, po ashtu, ritheksoi mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për Gjykatën Speciale, puna e së cilës është jetike për të sjellë drejtësi për viktimat dhe për ta forcuar shtetin ligjor në Kosovë. Taksa ndaj mallrave serbe është vendosur në vitin 2018 nga qeveria e ish-kryeministrit Ramush Haradinaj. Serbia e ka pezulluar pjesëmarrjen në dialogun për normalizimin e raporteve me Kosovën, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, duke kërkuar shfuqizimin e tarifës.

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, pas takimit me Pompeon, ka shprehur mirënjohjen e thellë të popullit dhe institucioneve të Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dekada me radhë. “Na keni

përkrahur në kohët më të vështira si dhe në ditët më të mira tona. Mirënjohja jonë është e përhershme”, është shprehur presidenti Thaçi.

Ai ka bërë me dije se temë e diskutimit me Pompeon ishte edhe dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Marrëveshja e përhershme e paqes, në mes të Kosovës dhe Serbisë, do të thotë paqe për tërë Evropën Juglindore, do të thotë kthim kah e ardhmja, do të thotë zhvillim dhe prosperitet”, ka thënë presidenti Thaçi në takim.

Presidenti Thaçi u shpreh se Kosova do të vazhdojë të bashkërendojë çdo hap të saj

me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. “Duke ecur bashkë me Uashingtonin i kemi realizuar aspiratat tona”, ka thënë Thaçi.

Gjatë qëndrimit në Uashington, presidenti Thaçi ka zhvilluar takime edhe në Departamentin e Mbrojtjes, ku është pritur nga nënsekretari i Mbrojtjes së ShBA-së, David L. Norquist. Sipas Zyrës së Shtypit të Pentagonit, nënsekretari Renquist përshëndeti Kosovën në vitin e saj të parë të një plani transitor 10-vjeçar për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Sigurisë.

Ndërkaq presidenti Thaçi ka thënë se takimi me zyrtarët e

lartë të Pentagonit ka qenë i frytshëm si dhe ka shprehur falënderim për mbështetjen e ShBA-së për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në rrugën e anëtarësimit të saj në NATO. “Kosova tashmë e ka ushtrinë e vet profesionale dhe me standarde të NATO-s, që është e gatshme gjithmonë të përfshihet në misionet humanitare e paqeruajtëse në botë, krah për krah me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne ndamë bindjen e njëjtë se është vitale për sigurinë në Evropën Juglindore që Kosova të jetë sa më shpejt anëtare e NATO-s”, ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në “Facebook”.

Zëvendëspresidenti i Parlamentit Evropian porositi Kosovën që ta luftojë korrupsionin

PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim zëvendëspresidentin e Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, i cili ka qenë i shoqëruar nga disa kryetarë komunash dhe biznesesh gjermane.

Nënkryetari i Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, ka shprehur entuziazmin për formimin e qeverisë së re dhe për synimin e saj për ta luftuar korrupsionin.

Kryeministri Kurti ka konfirmuar këtë pritshmëri të brendshme dhe të jashtme. Ai ka pohuar se zhvillimi ekonomik sjell punësim dhe luftimi i korrupsioni sjell drejtësi. “Lufta ndaj korrupsionit do të bëhet në koor-



dinim me tërë aktorët”, ka deklaruar kryeministri Kurti. Mes temave të tjera të përmendura prej Wieland ishin shkëmbimi i përvojave në fushën e arsimit, vënia e theksit në politikat komunale, nxitja e edukim-

it në fushën e administratës publike si dhe nxitja e prodhimit vendës.

Edhe kryeministri Kurti ka theksuar se investimet nga jashtë ndihmojnë strukturimin e ekonomisë së brendshme.

Edhe kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, është takuar me zëvendëspresidentin e Parlamentit Evropian, Rainer Wieland. Osmani i ka thënë zëvendëspresidentit të Parlamentit Evropian se synon ta fuqizojë edhe më tej rolin e Kuvendit si dhe ta rrisë mbikëqyrjen efektive ndaj qeverisë. Në këtë kontekst, ajo ka potencuar se, sikurse edhe në Gjermani, Kuvendi i Kosovës po përpillet ta reduktojë përdorimin e letrës, duke i dhënë një fokus të veçantë zhvillimit të politikave mjedisore.

Kurse zëvendëspresidenti i PE-së, Rainer Wieland, ka shprehur interesimin që të vazhdojë projektin i shkëmbimit të nxënësve

me komunat gjermane. Në të njëjtën kohë, ai ka ftuar për vizitë në Baden-Württemberg një delegacion nga Kosova, në funksion të shkëmbimit të përvojës parlamentare dhe asaj nga pushteti lokal. Në diskutimin e tij, Wieland ka potencuar rëndësinë e politikave arsimore dhe luftës kundër korrupsionit. Ndërkaq kryekuvendarja Osmani e ka cilësuar korrupsionin pengesë kryesore për investitorët dhe në të njëjtën kohë ka thënë se institucionet e tashme të Kosovës e kanë prioritet luftën ndaj kësaj dukurie. Ajo ka falënderuar Wielandin për mbështetjen e deritashme dhe ka thënë se projektet me të cilat shkëmbehet dija, e ndihmojnë fuqishëm Kosovën.



Flet për “Epokën e re”, Naser Ramadani

NUK KA VEND PËR PANIK, KEMI MARRË MASA PËR KORONAVIRUSIN

Drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, Naser Ramadani, u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që të mos kenë panik nga koronavirusi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se institucionet e Kosovës i kanë marrë të gjitha masat që kërkohen nga Organizata Botërore e Shëndetësisë për t’u mbrojtur nga kjo epidemi. Ramadani ka treguar se Kosova është e rrezikuar nga kjo epidemi aq sa janë të rrezikuara vendet e tjera. Sipas tij, jo çdo qytetar i prekur nga ky virus ka nevojë për ndihmë mjekësore. Ramadani ka treguar se në parapërgatitjet që kanë bërë kanë paraparë edhe hapjen e karantinës

mirëpo më pas testi ka rezultuar negativ. Pra, deri më tani nuk kemi asnjë rast të identifikimit me koronavirus. Ne jemi duke dedektuar të gjitha rastet dhe jemi nën kontroll të plotë epidemik.

“Epoka e re”: Sa është e rrezikuar Kosova ndaj këtij virusi?

Ramadani: Kosova është e rrezikuar nga koronavirusi si çdo vend tjetër pa dallim në Ballkan ose në Evropë.

“Epoka e re”: Sa jeni të përgatitur si institut të përballeni me këtë virus?

Ramadani: Institutit Kombëtar i Shëndetit Publik tashmë është përgatitur dhe ka një muaj e gjysmë që i ka të gjitha dokumentet përkatëse për të gjitha aktivitetet e parandalimit. Laboratori është furnizuar dy javë pasi kanë dalë rezultatet e para prej prodhimit. Janë bërë më shumë se tri javë që IKShP është furnizuar me analiza laboratorike të nivelit më të lartë të laboratorëve më prestigjiozë

evropianë. Pra, ne i kemi bërë të gjitha parapërgatitjet dhe të gjithë aktorët janë identifikuar. Mendoj se jemi të gatshëm që të përballemi me këtë virus.

“Epoka e re”: Cila janë masat që i kanë marrë institucionet qendrore për t’u mbrojtur nga ky virus?

Ramadani: Ne i kemi marrë të gjitha masat e parapara me planin e gatishmërisë dhe kontingjentës që parashihet sipas protokolleve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

“Epoka e re”: Kosova ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore që të përballat me këtë epidemi?

Ramadani: Besoj se kemi kapacitete të mjaftueshme njerëzore për t’u përballur me koronavirusin.

“Epoka e re”: Shumë vende kanë paraparë edhe hapjen e karantinave. Institucionet e Kosovës kanë menduar për këtë gjë?

Ramadani: Edhe në parapërgatitjet që kemi bërë kemi

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 27 SHKURT - Drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, Naser Ramadani, ka bërë me dije se Kosova i ka mobilizuar të gjitha kapacitetet e veta profesionale për t’u përballur me koronavirusin. Ai ka ftuar qytetarët e Kosovës që të mos kenë panik, por përkujdesje ndaj epidemisë që ka goditur mbarë globin.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, Ramadani ka deklaruar se Kosova është e gatshme të përballat me këtë virus. “Mesazhi im për gjithë

qytetarët e Republikës së Kosovës është se ata nuk duhet të kenë panik nga koronavirusi, por duhet të kenë përkujdesje. Kjo përkujdesje bëhet duke e ruajtur higjienën personale duke mos shkuar në ambiente ku ka shumë njerëz dhe të qëndrojnë në shtëpi mundësisht”, ka thënë ai.


Ramadani ka treguar se jo çdo qytetar i prekur nga ky virus ka nevojë për ndihmë mjekësore. “Institucionet e Kosovës janë të përgatitura që t’i dalin në ndihmë çdo qytetari që ka nevojë. Mirëpo, jo çdo qytetar i cili preket nga koronavirusi ka nevojë për ndihmë mjekësore. Nevojë për ndihmë mjekësore kanë vetëm

ata persona që kanë gjendje të rëndë klinike”, është shprehur Ramadani.

Më tej, drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik ka treguar se pse Kosova ende nuk është prekur nga koronavirusi. Sipas tij, vetëdijesimi i hershëm i qytetarëve për këtë epidemi mund të ketë ndikuar në këtë drejtim.

“Epoka e re”: Z. Ramadani, deri më tani në Kosovë janë dyshuar disa persona me koronavirus, por pas ekzaminimeve askush nuk ka rezultuar pozitiv me këtë virus.

Ramadani: Është e vërtetë se kemi pasur disa raste të dyshuara,



paraparë hapjen e karantinës.

“Epoka e re”: Në cilin vend është paraparë hapja e karantinës?

Ramadani: Ne si institut vetëm japin ide për ta hapur karantinë, tjetërkush ka kompetencë për hapjen e saj.

“Epoka e re”: Tanimë ekziston një lloj paniku te qytetarët për këtë virus. Cila është kështilla juaj për ta?

Ramadani: Mesazhi im për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës është se ata nuk duhet të kenë panik nga koronavirusi, por duhet të kenë përkujdesje. Kjo përkujdesje bëhet duke e ruajtur

higjienën personale, duke mos shkuar në ambiente ku ka shumë njerëz dhe të qëndrojnë në shtëpi mundësisht.

“Epoka e re”: Pra, qytetarët e Kosovës duhet të ndihen të sigurt se institucionet e shtetit do t’u dalin në ndihmë?

Ramadani: Institucionet e Kosovës janë të përgatitura që t’i dalin në ndihmë çdo qytetari që ka nevojë. Mirëpo, jo çdo qytetar i cili preket nga koronavirusi ka nevojë për ndihmë mjekësore. Nevojë për ndihmë mjekësore kanë vetëm ata persona që kanë gjendje të rëndë klinike.

“Epoka e re”: Deri më tani Kosova dhe Shqipëria janë pothuajse vendet e vetme në rajon që nuk janë prekur nga koronavirusi. Pse mendoni se po ndodh kjo?

Ramadani: Unë mund të flas vetëm për Kosovën, sepse për Shqipërinë nuk jam përgjegjës. Sa i përket Kosovës, në bazë të parapërgatitjeve dhe dedektimit të hershëm, ne e kemi vënë vigjilencën dhe mbikëqyrjen ndaj sëmundjes që nga 1 janari i vitit 2020.

“Epoka e re”: Mendoni se kjo vigjilencë e hershme ka ndikuar në vetëdijesimin e qytetarëve?

Ramadani: Gjithsesi se ka ndikuar. Vetëdijesimi i qytetarëve me kohë, duke iu treguar atyre informacionet e duhur për këtë virus dhe duke iu treguar se si duhet të mbrohem, natyrisht se ndikon.

“Epoka e re”: Për sa kohë do të jetë e nevojshme mbajtja e këtyre masave, si kontrolli në kufi dhe masat e tjera?

Ramadani: Kontrollat kufitare dhe në aeroport për këtë virus i kemi vendosur prej fillimit. Pra, kontrollat në pikat kufitare ne i bëjmë për më tepër se një muaj. Ne nuk dimë për kohëzgjatjen e kësaj epidemie. Por, ne i kemi marrë masat për hulumtimet epidemiologjike dhe mbajtjen nën kontroll të epidemisë.

Diskutohet për menaxhimin e situatës lidhur me koronavirusin

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 SHKURT - Ministri i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Agim Veliu, ka pritur të enjten në takim ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia dhe drejtorin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, Naser Ramadani, me të cilët kanë diskutuar për menaxhimin e situatës lidhur me koronavirusin.

Me këtë rast, ministri Vitia ia ka bërë me dije ministrit Veliu angazhimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike për ndërmarrjen e masave për një situatë të re të

mundshme epidemiologjike që ka përfshirë disa vende të botës dhe që potencialisht edhe vendi ynë mund të preket.

Ministri Vitia ka theksuar se Ministria e Shëndetësisë ka autorizuar IKShPK-në që t’i mobilizojë të gjithë kapacitetet profesionale për menaxhimin e kësaj situatë, megjithatë ai ka theksuar se për këtë është e nevojshme një gjithëpërfshirje institucionale dhe ndihma e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, për ta menaxhuar çfarëdo situatë që mund të ballafaqohemi në të ardhmen.

Ndërsa ministri i MPBAP-së, Agim Veliu, ka theksuar përkushtimin e tij se të gjitha kapacitetet

institucionale që ka kjo ministri do të vihen në dispozicion për të menaxhuar çfarëdo situatë epidemiologjike që mund të paraqitet. Ai ka pohuar se institucionet e sigurisë do të jenë të gatshme dhe në funksion të shtetit për çfarëdo nevojë që kërkohet, në mënyrë që situata të kontrollohet nga të gjitha mekanizmat e shtetit si tërësi.

Të dy ministrat vlerësuan se situata për momentin është stabile dhe deri më tani asnjë qytetar i Kosovës nuk është prekur nga ky virus, prandaj nuk ka nevojë për panik. U theksua në këtë takim se është e rëndësishme që të ndiqen udhëzimet nga IKShPK-ja për kujdes në mënyrë që ky virus të mos bartet edhe në Kosovë.



SBASHK-u, qeverisë: Në Ligjin e buxhetit për vitin 2020 planifikoni mjetet për Ligjin e pagave

PRISHTINË, 27 SHKURT - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përmes një komunikate për media ka theksuar se nëse Ministria për Financa nuk bën planifikime buxhetore për Ligjin e pagave dhe qeveria përkrah një ide të tillë, atëherë në tërë sistemin arsimor do të përsëritej situata e janarit të vitit të kaluar, gjegjësisht bazuar në kërkesat e anëtarësisë do të ketë veprime sindikale dhe grevë në nivel vendi nga çerdhet, institucionet e arsimit parauniversitar dhe në të gjitha universitetet publike. “Ngatërriimet që ishin bërë pa qëllim mes Ligjit për zyrtarët publikë dhe atij të Pagave te

lajmi lidhur për zgjatjen e masës së pezullimit nga Kushtetuesja edhe për një muaj kishin krijuar tensione shtesë tek te gjithë anëtarësia e SBASHK-ut. Tensionet janë shtuar edhe më tepër nga lajmi i shpërndarë, që urojmë të mos jetë i saktë, se Ministria e Financave, duke përgatitur Projektligjin e buxhetit për vitin 2020, nuk do të planifikojë fare mjete për implementimin e Ligjit të pagave. SBASHK-u u drejtohet me këshillën publike kryeministrit Kurti dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, që duke planifikuar Projektligjin për buxhetin e vitit 2020 të mos e harrojnë Ligjin e pagave,

implementimin e të cilit më të drejtë e presin mijëra të punësuar në sektorin publik, mes tyre edhe ata në sektorin e arsimit”, është thënë në komunikatën e SBASHK-ut. Më tej në këtë komunikatë është theksuar se SBASHK-u, me qëllim që çështjet të sqarohen me dialog, i ka dërguar kërkesë kryeministrit Albin Kurti për takim në afatin më të afërt të mundshëm, qoftë edhe në ditët e fundjavës, ndërsa të hënën do të mbajë takim të jashtëzakonshëm konsultativ lidhur me situatën me kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe të universiteteve për të marrë hapa dhe veprime konkrete karshi situatës.



Tërnavë pret në Kosovë delegacionin e lartë nga Qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe

“Shprehim konsideratën tonë ndaj Emirateve të Bashkuara Arabe për përkrahjen që i kanë dhënë Kosovës gjatë ngjarjeve më të rëndësishme për lirinë dhe për shtetndërtimin e saj”, ka thënë kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, gjatë takimit me delegacionin e lartë të Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe në Prishtinë



Delegacioni i Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe vizitoi KBI e Shtimes dhe Pejës

Kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë dhe delegacionin e kryesuar nga dr.

kryetari i KBI të Shtimes, Skender ef. Baftiu, i cili u dëshiroi mirëseardhje mysafirëve, duke i njoftuar ata me jetën fetare dhe veprimtarinë që po bëhet nëpër xhami të Shtimes dhe ka falënderuar myftiun Tërnavë dhe EBA-në për investimet që bënë për KBI të Shtimes. Me këtë rast, po ashtu myftiu Tërnavë ka

ndërkombëtarë.

Në xhaminë Lagjia e Pajtimt u mbajt edhe një ligjëratë e shkurtër para xhematit, duke çmuar vlerën e diturisë dhe bamirësisë. Më pas vizituan hapësirat e objektit të selisë së ndërtuar për nevoja të KBI të Shtimes, cili është një objekt tepër modern dhe ofron kushte të mira dhe më komode për punë. Dr. Mirza As Saeg ka theksuar se myftiu Tërnavë dhe BIRK gëzojnë mbështetje të madhe në qeverinë e EBA-s dhe popullit të saj.

Po ashtu, kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë dhe delegacionin e Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, vizituan Këshillin e BI të Pejës dhe disa objekte vakufnore të ndërtuara nga Fondacioni “Al Maktum”.

Me këtë rast në pritje të tyre ishte kryetari i KBI të Pejës, Musli ef. Arifi, i cili u ka uruar mirëseardhje mysafirëve, duke i njoftuar ata me jetën fetare dhe veprimtarinë që po bëhet nëpër xhami të Pejës. Ai ka falënderuar myftiun Tërnavë dhe EBA-në për investimet që bënë për KBI të Pejës.

Dr. Mirza As Saeg ka pohuar se ndihet i nderuar nga pritja tepër vëllazërore nga myftiu Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij, duke premtuar se do ta ndihmojë Kosovën edhe në projekte të tjera.



Mirza As Saeg, shef i kabinetit të ministrit të Financave të Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA), njëherësh edhe anëtar i Fondacionit “Al Maktum”, vizituan selinë e Këshillit të BI të Shtimes dhe xhaminë e lagjes të ndërtuar nga Fondacioni “Al Mektoum”.

Me këtë rast, në pritje të tyre ishte

falënderuar delegacionin e EBA-s përmes dr. Mirza As Saeg, qeverinë dhe popullin e EBA-s për ndihmën që i kanë ofruar Kosovës gjatë dhe pas luftës si dhe në lobimin që bënë EBA që shteti ynë të njihet edhe më shumë në skenën ndërkombëtare si dhe për integrimin e Kosovës në mekanizma rajonale dhe në ata

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 SHKURT - Kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë, ka pritë në takim delegacionin e kryesuar nga dr. Mirza As Saeg, shef i kabinetit të ministrit të Financave të Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA), njëherësh anëtar i Fondacionit “Al Maktum”.

Në mënyrë solemne përruruan projektin, ndërtesën e Këshillit të BI-së së Kamenicës. Me këtë rast, myftiu Tërnavë i ka uruar mirëseardhje delegacionit nga EBA dhe e ka falënderuar për vizitën, duke e njoftuar me organizimin e BI-së së Kosovës. Myftiu Tërnavë ka falënderuar, përmes dr. Mirza As Saeg, qeverinë dhe popullin e EBA-së

edukative dhe për këtë ndihet falënderues dhe mirënjohës për popullin dhe për Qeverinë e Emirateve që po ndihmojnë në ngritjen e infrastrukturës dhe në realizimin e shumë projekteve të BIRK-ut.

Nga ana e tij, dr. Mirza As Saeg, shef i kabinetit të ministrit të Financave të Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA) dhe anëtar i Fondacionit “Al Maktum”, gjatë fjalës së tij përcolli përshëndetjet e shejh Hamdan Al Rashid, i cili ka vëmendje të veçantë për Kosovën dhe popullin e saj. Ai tha se Qeveria e EBA-së ka vendosur Kosovën në krye të shteteve që meriton ndihmën. “Me udhëzimet e EBA-së ne e shikojmë Kosovën shtet mik dhe ndjekim nga afër situatën dhe gjendjen nëpër të cilën po kalon



për ndihmën që i ka ofruar Kosovës gjatë dhe pas luftës si dhe për lobimin që bënë EBA-ja që shteti ynë të njihet edhe më shumë në skenën ndërkombëtare si dhe për integrimin e Kosovës në mekanizma rajonale dhe në ata ndërkombëtarë.

Ai më pas edhe një herë ka shprehur qëndrimin dhe angazhimin që ka BIRK-u që Kosova të jetë një vend i qetë, ku të gjitha komunitetet fetare të jetojnë në paqe, dashuri dhe me respekt të ndërsjellë. “Shprehim konsideratën tonë ndaj Emirateve të Bashkuara Arabe për përkrahjen që i kanë dhënë Kosovës gjatë ngjarjeve më të rëndësishme për lirinë dhe për shtetndërtimin e saj”, ka thënë myftiu Tërnavë.

Myftiu Tërnavë vlerësoi lart edhe bashkëpunimin me shtetin mik të EBA-së, duke theksuar ndihmën në shumë fusha si në jetën ekonomike, kulturore, sociale,

Kosova. Marrëdhëniet po fuqizohen. Ky është një fillim i vogël. Po premtoj se do të angazhohemi edhe për projekte të tjera dhe për shtim të vizitave mes dy qeverive”, ka thënë ai. Ai ka theksuar se myftiu Tërnavë dhe BIRK-u gëzojnë mbështetje të madhe në Qeverinë e EBA-së dhe në popullin e saj.



Vritet në mënyrë misterioze luftëtari i orëve të para të UÇK-së, Qerim Kelmendi

Në orët e para të mëngjesit të ditës së enjte, ish-luftëtari i UÇK-së, Qerim Kelmendi nga fshati Llabjan i Pejës, është gjetur i vdekur brenda veturës së tij e cila ishte djegur. Sektori Rajonal i Hetimeve pranë Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë ka njoftuar se në bashkëpunim të plotë me Prokurorin e Shtetit janë duke u marrë të gjitha veprimet hetimore për t'i sqaruar rrethanat e këtij rasti të cilësuar 'vrasje'. Për vrasjen e Qerim Kelmendit kanë reaguar përfaqësuesit e institucioneve të vendit, presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Albin Kurti, liderë partish, kryetarë komunash, OVLUÇK-ja dhe bashkëluftëtarë të Qerim Kelmendit, duke e cilësuar këtë vrasje mizore. Ata u kanë bërë thirrje organeve të drejtësisë që sa më shpejt ta zbardhin këtë rast



QERIM KELMENDI
ISH LUFTËTAR I UÇK

me gjithë kapacitetin e tyre këtë vrasje mizore që është më shumë se krim”, ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në “Facebook”.

Haradinaj: U bëj thirrje organeve të drejtësisë që sa më shpejt të zbardhin rastin

Ish-kryeministri dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka reaguar për vrasjen e ish-ushtarit të UÇK-së, Qerim Kelmendi. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në “Facebook” u ka shprehur ngushëllime familjes Kelmendi dhe bashkëluftëtarëve të Qerim Kelmendit. “Sot me pikëllim morëm lajmin për vrasjen e bashkëluftëtarit të orëve të hershme të UÇK-së, Qerim Kelmendi. Familjes dhe bashkëluftëtarëve u shpreh ngushëllimet e sinqerta! U bëj thirrje organeve të drejtësisë që sa më shpejt ta zbardhin rastin”, ka shkruar Haradinaj.

Limaj: Me dhimbje të thellë mora lajmin për vrasjen e Qerim Kelmendit, luftëtarit të orëve të para të UÇK-së

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka reaguar për vrasjen e Qerim Kelmendit, ish-luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Limaj përmes një postimi në “Facebook” u ka bërë thirrje institucioneve të drejtësisë që konform përgjegjësisë që kanë të marrin masa të menjëhershme në

funkcion të zbardhjes së kësaj vrasje. “Me dhimbje të thellë mora lajmin për vrasjen e Qerim Kelmendit, luftëtar i orëve të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. U bëj thirrje institucioneve të drejtësisë që konform përgjegjësisë që kanë të marrin masa të menjëhershme në funksion të zbardhjes së kësaj vrasje. Familjes Kelmendi, miqve dhe bashkëluftëtarëve të Qerimit u shpreh ngushëllimet më të sinqerta”, ka shkruar Limaj.

Lladrovci: Vrasja e Qerim Kelmendit, akt i rëndë kriminal

Vrasjen e Qerim Kelmendit e ka dënuar edhe kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, i cili ka thënë se ky është akt i rëndë kriminal në shtetin tonë të lirë për të cilin Qerimi dha shumë kontribut. “Me pikëllim të madh mora lajmin se është vrarë Qerim Kelmendi afër shtëpisë së tij. Ky është akt i rëndë kriminal në shtetin tonë të lirë për të cilin ai dha shumë kontribut. Ngushëllime familjes Kelmendi, dashamirëve, bashkëveprimtarëve dhe bashkëluftëtarëve të tij! I përjetshëm do të jetë kujtimi për Qerim Kelmendin!”, ka shkruar Lladrovci në llogarinë e vet në “Facebook”.

Rexhep Selimi: Qerim Kelmendi u vra në një pritë të rëndë siç është edhe vdekja e tij e rëndë

Shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka reaguar në lidhje me vrasjen e ish-luftëtarit të UÇK-së, Qerim Kelmendi. Ai ka thënë se Qerim Kelmendi ishte luftëtar i hershëm i UÇK-së. Selimi ka thënë se Kosova duhet ta çlirojë veten nga enigma e kësaj vrasje dhe e vrasjeve të tjera. “Qerim Kelmendin e njoha prej kohësh. Ai ishte luftëtar i hershëm i UÇK-së. Ai u vra sot në një pritë të rëndë siç është edhe vdekja e tij e rëndë. Kosova duhet ta çlirojë veten nga enigma e kësaj vrasje dhe e vrasjeve të tjera. Policia e prokuroria të mos ndalen në punën e tyre. Ngushëllime bashkëluftëtarëve, miqve e familjes!”, ka shkruar Rexhep Selimi në llogarinë e vet në “Facebook”.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PEJË, 27 SHKURT - Të enjten rreth orës 1:27, në orët e para të mëngjesit, është vrarë në fshatin Zahaq të Pejës, në mënyrë misterioze, ish-luftëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Qerim Kelmendi. Sipas njoftimit të Policisë së Kosovës, fillimisht Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë, është informuar se në fshatin Zahaq në një rrugë është duke u djegur një veturë. “Me të marrë informatën njësitet e Stacionit Policor në Pejë kanë shkruar në vendngjarje, ku kanë vërejtur një veturë e cila ishte përfshirë tërësisht nga zjarri. Në vendin e ngjarjes kanë arritur njësitet e zjarrfikësve të cilët e kanë shuar zjarrin. Gjatë kohës derisa zjarrfikësit ishin duke lokalizuar zjarrin në brendësi të veturës është vërejtur një person (viktimë mashkull), trup i karbonizuar. Vëndit të ngjarjes i janë përgjigjur njësitet relevante të sektorit rajonal të hetimeve, njësitë K9, si dhe prokurori i shtetit dhe ekipi mjekësor, të cilët kanë konstatuar vdekjen e viktimës. Gjatë shikimit të vendit të ngjarjes është konstatuar se vetura e djegur është e tipit VW (Passat), me targa vendore”, është thënë në njoftimin e Policisë.

Më tej në njoftim është theksuar se Sektori Rajonal i Hetimeve pranë Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë, në bashkëpunim të plotë me Prokurorin e Shtetit, janë duke marrë të gjitha veprimet hetimore për t'i sqaruar rrethanat e këtij rasti të cilësuar 'vrasje' dhe janë duke u bërë përpjekje maksimale për ta identifikuar kryesin ose kryesit e mundshëm.

Për vrasjen e Qerim Kelmendit kanë reaguar përfaqësuesit e institucioneve të vendit, liderë partish, kryetarë komunash, OVLUÇK-ja dhe bashkëluftëtarë të Qerim Kelmendit.

Veprimtari, vëllai i Qerim Kelmendit, Ibrahim Kelmendi, përmes një postimi në llogarinë e vet në “Facebook” ka shkruar se kjo vrasje është kryer nga dora e zgjatur vrastare e Serbisë. “Mallkimi dhe turpi ju mbulofshin!”, ka shkruar Ibrahim Kelmendi.

Ndërkaq vëllai tjetër i Qerim Kelmendit, Osmani, ka treguar se vëllai i tij është vrarë dhe më pas edhe djegur në makinën e tij. “Vrasja ka ndodhur në mesnatë,

pas orës 1:25, afër shtëpisë. Ka qenë një pritje klasike, si duket mirë e përgatitur. E kanë ekzekutuar një herë, pastaj e kanë djegur kufomën me gjithë makinë. Ai ka lëvizur në qytet, sepse ka pasur miq e shokë. Nuk e ka pasur asnjë drojë, asnjë element të dyshimtë që të mos lëviz gjatë ditës e gjatë natës. Ai ka qenë invalid luftime. Nuk ka qenë në punë që ta ketë një orar të rregullt. Kështu krejt çfarë dimë është kjo. Pistë të dyshimtë nuk kemi. Historia e vëllait është kjo, ai ka qenë luftëtar i orëve të para, ka qenë së bashku me Adrian Krasniqin, Ilir Konushevcin dhe Zahir Pajazitin”, ka thënë Osman Kelmendi.

Presidenti Thaçi: Vrasja tinëzare e Qerim Kelmendit, tronditëse

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka reaguar pas vrasjes së ish-luftëtarit të orëve të para të UÇK-së, Qerim Kelmendi. Ai ka thënë se vrasja tinëzare e Kelmendit është tronditëse për të dhe të gjithë qytetarët e Kosovës. Thaçi u ka bërë thirrje organeve të drejtësisë që ta zbardhin sa më shpejt këtë rast. “Vrasja tinëzare e Qerim Kelmendit, njërit prej luftëtarëve më të hershëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte tronditëse për mua dhe të gjithë qytetarët e Kosovës. U bëj thirrje urgjente institucioneve të rendit dhe ligjit, që ta zbardhin këtë vrasje të tmerrshme sa më shpejt që është e mundur dhe kryesit e saj t'i vënë para drejtësisë. Familjes Kelmendi dhe gjithë bashkëluftëtarëve të Qerimit u shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta, duke i siguruar se do t'i përdorim të gjithë mekanizmat ligjorë të shtetit për ta zbardhur këtë vrasje mizore!”, ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në “Facebook”.

OVLUÇK-ja: Kur vriten luftëtarët në kohë paqe e në mënyrë makabre, vritet liria

Edhe Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka reaguar ashpër për vrasjen e ish-luftëtarit të UÇK-së, Qerim Kelmendi. Përmes një komunikate OVLUÇK-ja ka kërkuar nga organet e drejtësisë që të zbulojnë sa më shpejt krimin e bërë dhe përgjegjësit ta marrin dënimin e merituar. “Organizata e

Veteranëve të Luftës së UÇK-së reagon ashpër në lidhje me vrasjen e më pastaj djegien e luftëtarit të orëve të para të luftës së UÇK-së, Qerim Kelmendi. Vrasja e bashkëluftëtarit tonë është një lajm shumë i dhimbshëm për ne. Kërkojmë nga organet e drejtësisë që sa më shpejt ta zbulojnë këtë krim dhe përgjegjësit ta marrin dënimin e merituar”, thuhet në komunikatë. Tutje, në këtë komunikatë thuhet se kur vriten luftëtarët e lirisë në mënyrë makabre, vitet liria. “Kur vriten luftëtarët e lirë në kohë paqe e në mënyrë makabre, vritet liria. Ngushëllime familjes dhe shokëve të tij!”, thuhet në komunikatën e OVLUÇK-së.

Kurti për vrasjen e Qerim Kelmendit: Policia dhe prokuroria ta hetojnë këtë vrasje mizore

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka reaguar për vrasjen e ish-ushtarit të UÇK-së, Qerim Kelmendi. Me këtë rast, Kurti ka thënë policia dhe prokuroria duhet ta hetojnë me gjithë kapacitetin e tyre këtë vrasje mizore që është më shumë se krim. “Herët nga ministria e pastaj nga mediat mësuam se është vrarë dhe djegur në makinën e tij, Qerim Kelmendi, ish-ushtar i UÇK-së. 21 vjet pas luftës, në kohë të paqes, askush nuk duhet të jetojë me ndjenjën e frikës e sidomos ata që sakrifikuan më së shumti. Policia dhe prokuroria duhet ta hetojnë



Drejtuesit e AKP-së takuan përfaqësuesit e FMN-së

PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Bajram Zejnullahu dhe drejtori menaxhues Valon Tolaj, kanë pritur në takim një delegacion të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) të kryesuar nga Gabriel Di Bella,

shef i Misionit për Kosovë që vepron në kuadër të Departamentit Evropian. Kryesuesi i Bordit dhe drejtori menaxhues i AKP-së e njoftuan shefin e Misionit të FMN-së me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, me aktivitetet e fundit të AKP-së si dhe me pasqyrat

financiare dhe planin e punës të agjencisë për fazat e ardhshme. Në anën tjetër, Gabriel Di Bella ka falënderuar drejtuesit e AKP-së për pritjen e organizuar dhe informacionet e ofruara në lidhje me progresin në transformimin e pronës shoqërore dhe zhvillimet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.



Çmimet e produkteve bujqësore shënuan rritje



**EPOKA
ERE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 SHKURT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi për periudhën 2015-2019". Sipas metodologjisë së Eurostatit, ASK-ja ka bërë ndërrimin e vitit bazik të indeksit të çmimeve të inputeve në bujqësi nga 2010=100 në 2015=100. Për të bërë krahasime dhe për t'i vërejtur ndryshimet janë prezantuar të dhëna për vitet

2015-2019 dhe për vitin bazë 2015. Publikimi është i bazuar në çmimet e inputeve bujqësore të grumbulluara në Kosovë. Sipas njoftimit të ASK-së, grumbullimi i çmimeve është kryer në barnatoret bujqësore, farmacitë veterinarë, në kompani, tregje dhe në vende të tjera, ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion. "Disa çmime të inputeve bujqësore janë marrë nga çmimet e konsumit (IHÇK) në ASK. Produktet, të cilat e përbëjnë bazën për Indeksin e Çmimit të Inputeve, janë të

ndara në dy grupe kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (Input 1) dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet në bujqësi (Input 2). Brenda grupit të mallrave dhe shërbimeve aktualisht të konsumuara në bujqësi, çmimet grumbullohen sipas grupeve në vijim: farëra dhe material mbëltues, energji; vajra, plehra dhe përmirësues të tokës, produkte për mbrojtjen e bimëve dhe pesticide, shpenzime për veterinarin, lëndë për ushqimin e kafshëve,

mirëmbajtje e materialeve, mirëmbajtje e ndërtesave, si dhe mallra dhe shërbime të tjera. Sa iu përket mallrave dhe shërbimeve që kontribuojnë në investimet bujqësore, çmimet grumbullohen për materiale (makineri dhe pajisje të tjera), ndërtesat dhe të tjera (ndërtesat jorezidente të fermës, punët e tjera përveç përmirësimit të tokës)", thuhet në njoftimin e ASK-së. Sipas këtij njoftimi, në vitin 2019 indeksi vjetor i inputeve ka rritje për 2.0 për qind për Input 1 krahasuar me periudhën e njëjtë

të vitit 2018. Kurse Indeksi për Input 2 ka rritje për 7.1 për qind në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018. Indeksi i inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) në vitin 2019 ka rritje për 4.3 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Në vitin 2019 indeksi vjetor i inputeve ka rënie për -4.2 për qind për Input 1 krahasuar me vitin 2015. Indeksi për Input 2 ka rritje për 9.9 për qind në mes viteve 2015 dhe 2019. Indeksi i inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) ka rritje për 2.1 për qind krahasuar me vitin 2015.

Ministri i Financave viziton ATK-në, ofron mbështetje

PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Ministri i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi, ka vizituar Administratën Tatimore të Kosovës, me ç'rast ka takuar menaxhentin e ATK-së. Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, duke falënderuar ministrin për vizitën, njoftoi për planet e ATK-së për vitin 2020 si

dhe të arriturat gjatë vitit paraprak, me theks të veçantë ka potencuar zvogëlimin e borxheve tatimore për të cilat ATK-ja ka marrë vlerësime pozitive edhe nga institucionet ndërkombëtare. Përveç rezultateve të arritura, drejtori Murtezaj përmendi edhe sfidat me të cilat ballafaqohet

administrata tatimore. Ndërkaq ministri Besnik Bislimi ka falënderuar drejtorin e ATK-së për prezantimin e të arriturave dhe sfidave të Administratës Tatimore të Kosovës. Gjatë kësaj vizite ministri Bislimi ka pohuar se Ministria e Financave dhe Transfereve do të mbështesë çdoherë ATK-në si dhe do t'i



trajtojë me përkushtim të gjitha kërkesat e adresuara në mënyrë

që të arrihen objektivat e planifikuara.

Këmbimi dhe bartja e pronës së komunave, mundësi për zhvillim ekonomik lokal



PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI) ka organizuar sesionin trajnues me temën “Dhënia në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës”, me fokus në këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe bartjen e pronës së paluajtshme të institucioneve qendrore në komuna. Pjesëmarrës në këtë sesion trajnues ishin përfaqësuesit nga drejtoritë për pronë dhe urbanizëm nga komunat e Kosovës dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Gjatë diskutimit u krahasuan mangësitë e ligjit paraprak dhe disa paqartësi të ligjit aktual deri në përcaktimin nëpërmjet akteve nënligjore për procedurat e dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale. Ligji për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës siguron shfrytëzimin efektiv të pronës së paluajtshme të komunës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, rritje të vlerës së pronës në shërbim të interesit të përgjithshëm. Pra, krijon mundësinë për këmbimin

e pronës dhe përfitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronat të cilat administrohen nga institucionet e shtetit si dhe bartjen e pronësisë së pronave të cilat administrohen nga AKP në pronësi të komunave. Sa i përket këmbimit të pronës së komunës, kjo bëhet vetëm për sigurimin e pronës për qëllime të përbushjes së interesit publik, duke iniciuar procedurat dhe përbushur kushtet e përcaktuara për këmbimin e pronës së komunës. Para së gjithash, komuna duhet ta

sigurojë vlerësimin e pronës së paluajtshme të komunës e cila është planifikuar për këmbim, në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi. Gjithashtu, komunat kanë të drejtë që për interes publik ta kërkojnë bartjen në pronësi të pronës së paluajtshme të cilat janë në territorin e komunës, por që administrohen nga institucionet qendrore. Krahas kësaj, komuna duhet ta bëjë identifikimin dhe përshkrimin e pronës së paluajtshme të cilën kërkon t'i bartet në pronësi për

realizimin e interesit publik. Me ndryshimet e ligjit aktual për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës u theksua se në të ardhmen ky ligj do t'u shërbejë dhe ndihmojë komunave që t'i realizojnë strategjitë e tyre për zhvillim ekonomik lokal. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit “Mbështetje për komuna më të forta dhe më të qëndrueshme (SSSM)”, i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë.

BE-ja investoi mbi 10 milionë euro në Shërbimin Korrektues të Kosovës



PRISHTINË 27 SHKURT (ER) - Bashkimi Evropian (BE) ka mbajtur pjesën përfundimtare të projektit për “Fuqizimin e mëtutjeshëm të shërbimit korrektues dhe shërbimit sprovues në Kosovë”. Ky projekt ka për qëllim mbështetjen e shërbimeve korrektuese dhe sprovuese të Kosovës si dhe

mbështetjen e Kosovës në përmirësimin e standardeve të sektorit gjyqësor duke e fuqizuar më tej kornizën institucionale. Përfaqësuesja Speciale e BE-së, Nataliya Apostolova, ka potencuar se duhet të merren masa esenciale për të burgosurit në integrimin e tyre në shoqëri. Apostolova ka theksuar se ky

projekt ka dhënë praktikën më të mirë evropiane për shërbimin korrektues dhe sundimin e ligjit në Kosovë. “BE-ja e ka mbështetur Kosovën në sundimin e ligjit. E ka mbështetur edhe Qendrën Korrektuese, burgjet. Që nga viti 2010 shuma e financimit ka kaluar mbi 10 milionë euro.

Personat në burgje janë të ndjeshëm dhe kanë drejt në të drejtat e tyre. Nga burgju që të kthehet në shoqëri duhen masa esenciale për integrim. Ky projekt është dizajnuar për ndarjen e përvojave më të mira të Evropës në Kosovë. Besoj se ka dhënë një praktikë të mirë në sektorin e shërbimit korrektues

dhe sundimin e ligjit”, ka thënë Apostolova. Ndërsa ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka theksuar se shërbimin korrektues e sheh si sfidë e qeverisjes, por edhe prioritet. Ajo ka premtuar se do të punojë në draftligjin për Shërbimin Korrektues në Kuvendin e Kosovës.

JA PËRSE DUHET TË PROTESTOJMË MË 2 MARS



Prof. Lisen BASHKURTI

Më 2 mars 2020 presidenti Meta ka thirrur popullin shqiptar në një tubim për mbrojtjen e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sundimit të ligjit, lirive dhe të drejtave të njeriut, mbrojtjen e popullsisë së vendit dhe integritetit territorial të Kosovës. Është e para herë që në vendin tonë presidenti i Republikës i drejtohet popullit drejtpërdrejt në një manifestim publik. Natyrisht, kjo nuk do të thotë se presidenti nuk gëzon të drejtën e komunikimit me qytetarët e vendit të vet. Madje, për vetë statusin kushtetues, si garantues i unitetit të popullit, presidenti gëzon plotësisht të drejtën për të komunikuar me qytetarët e vendit në të gjitha format demokratike, duke përfshirë edhe tubimet e drejtpërdrejta popullore. Specifikisht, presidenti Meta është presidenti më i hapur dhe më aktiv që ka pasur Shqipëria në historinë e saj. Dalja e presidentit Meta në një miting popullor dhe në mënyrë të veçantë kauzat për të cilën ka thirrur qytetarët më 2 mars 2020, ka ngjallur interesim të lartë publik kombëtar dhe ndërkombëtar. Mediat e huaja priten ta përcjellin me vëmendje të veçantë këtë tubim të presidentit Meta me popullin drejtpërsëdrejti nga Tirana.

1. Mbrojtja e Kushtetutës

Presidenti Meta prej korrikut 2016 ka qenë dhe mbetet personaliteti që ka mbështetur më së shumti reformën kushtetuese për sistemin e ri drejtësisë. Në krye të Kuvendit ishte pikërisht ai që

arriti konsensusin e plotë të ndryshimeve kushtetuese për reformën në drejtësi. Por, fryma e konsensusit që me shumë mundim u arrit për reformën kushtetuese për sistemin e drejtësisë, u ndërpre nga mazhoranca dhe qeveria aktuale, sapo mori kontrollin mbi legjislativin dhe ekzekutivin. Mbas zgjedhjeve të 2017-s shumë ligje dhe vendime që lidheshin me reformën në drejtësi shkelën frymën kushtetuese në përmbytje dhe në afatet kohore. Reforma në drejtësi hyri në një cikël krize, që e ka futur tërë vendin në një kolaps të vërtetë institucional.

Në krye të institucioneve të drejtësisë që po vuan krizën më të rëndë është Gjykata Kushtetuese. Vendi po përballlet me përplasje institucionale pikërisht nga mungesa e kësaj gjykate. Aktualisht kushtetueshmëria e vendit po mbrohet vetëm nga presidenti i Republikës. Mbi 23 ligje të miratuara nga Kuvendi aktual janë konsideruar antikushtetues nga dekretet e presidentit. Kulmimi i krizës ka arritur në vetë konstituimin e Gjykatës Kushtetuese.

Presidenti Meta, në mënyrë të vazhdueshme transparente ka informuar opinionin politik dhe publik, kombëtar dhe ndërkombëtar për shkeljet, arbitraritetin, manipulimet dhe falsifikimet që ka bërë mazhoranca dhe qeveria për të kapur dhe kontrolluar trupën e Gjykatës Kushtetuese. Presidenti i ka bërë publike në dinamike gjithë shkeljet e qëllimshme të mazhorancës dhe qeverisë për ta cenuar rëndë ndarjen dhe balancimin e pushteteve, me synimin tanimë të njohur kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht, për të kapur dhe kontrolluar Gjykatën Kushtetuese nga Kuvendi, qeveria dhe kryeministri Rama.

Mbasi ka bërë publike çdo hap të këtij deformimi të parimeve të

ndarjes dhe balancimit të pushteteve, presidenti Meta ka informuar edhe Komisionin e Venecias, faktorët relevantë ndërkombëtarë si dhe ka ndërmarrë hapat ligjorë, duke dërguar në SPAK dosjen për drejtuesit e KED-së dhe të Ministrisë së Drejtësisë për gjithë shkeljet, abuzimet, manipulimet dhe mashtrimet e bëra për kapjen dhe kontrollin e Gjykatës Kushtetuese nga mazhoranca, qeveria dhe kryeministri Rama. Këto të fundit, duke e parë rezistencën e fortë të presidentit Meta kundër përpjekjeve për kapjen dhe kontrollin e Gjykatës Kushtetuese ngritën Komision Parlamentar për shkarkimin e presidentit. Me këtë veprim ekstrem, mazhoranca, qeveria dhe kryeministri Rama ekspozuan lakuriqësinë e qëllimeve të tyre për kapjen dhe kontrollin e Gjykatës Kushtetuese, mbrojtjen e së cilës aktualisht po e bën vetëm dhe vetëm presidenti Meta. Pra, në thelb, përpjekja për shkarkimin e presidentit Meta është heqja e pengesës për kapjen dhe kontrollin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, e bashkë me të të gjithë sistemit të drejtësisë në vend nga mazhoranca, qeveria dhe kryeministri Rama. Për këto arsye thirrja e qytetarëve në tubim popullor nga presidenti për mbrojtjen e Kushtetutës dhe Gjykatës Kushtetuese është kauzë e vërtetë publike dhe kombëtare.

2. Mbrojtja e sundimit të ligjit

Qëllimi madhor i reformës kushtetuese të vitit 2016 për reformën në drejtësi ishte dhe mbetet garantimi i sundimit të ligjit në Shqipëri. Si parim themelor i rendit demokratik sundimi i ligjit garanton prevalimin dhe barazinë e ligjit për të gjithë qytetarët dhe

institucionet në Republikën e Shqipërisë. Mungesa e sundimit të ligjit është krejt e evidente në Shqipëri gjatë tërë tranzicionit afro 30-vjeçar. Dhe jo vetëm kaq, por në këto vitet e fundit situata e sundimit të ligjit në mjaft aspekte ka ardhur duke u përkeqësuar. Kështu, në strukturat qeverisëse të vendit, në Kuvend, në qeverinë qendrore, në qeverisjen vendore, në administratën publike dhe atë të sigurisë kanë depërtuar individë e grupe me rekorde kriminale, të cilët kanë inkriminuar politikën, qeverisjen dhe institucionet publike. Kjo lidhje e institucioneve politike dhe publike me krimin kombëtar dhe atë ndërkombëtar ka krijuar rrjetin e një sistemi mafioz që shkel dhe injoron sundimin e ligjit në Shqipëri dhe të ligjit ndërkombëtar, duke e bërë Shqipërinë një vend problematik brenda saj si dhe në fushën e rendit dhe të sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare.

Rritja e kriminalitetit në vend si dhe ekzistenca e grupeve të strukturuar kriminale, zgjerimi i trafikeve të paligjshme, sidomos i narko-trafikut, përfshirja e këtyre strukturave në rrjetet e narko-trafikut ndërkombëtar e rifutën Shqipërinë kohët e fundit sërish në hartën e shteteve me rrezikshmëri të lartë për pastrimin e parave. Pastrimi i parave e ka burimin nga kriminaliteti i lartë, narko-trafikat kombëtare dhe ndërkombëtare, struktura radikale dhe terroriste si dhe nga ana e vet, pastrimi i parave gjeneron informalitetin ekonomik e financiar në vend dhe financon krimin e organizuar dhe terrorizmin në të gjitha nivelet. Krimi i pastrimit të parave është një nga tri figurat penale më të rrezikshme ndërkombëtare që lulëzon aty ku mungon ose është shumë i dobët sundimi i ligjit. Krijimi i simbiozës midis kupolës politike dhe qeverisëse në Shqipëri me individë e grupe oligarke që zotërojnë

ekskluzivitete e monopole, që rrëmbejnë tenderë publikë pa konkurrencë e transparencë, që krijojnë partneritete publike-private apo që kapin koncesione nga më të ndryshmet në sektorë e me financa publike, është një tjetër fakt që dëshmon se në Shqipëri mungon në masë të konsiderueshme sundimi i ligjit dhe barazia përpara tij. Simbioza e kupolës politike dhe qeverisë me individë e grupe oligarke ka krijuar klimën dhe sjelljen autokratike dhe arbitrarë në vend, ku politikat publike janë në duart e pak njerëzve që lozin me fatet qytetarëve dhe të mbarë vendit. Inkriminimi i politikës, lidhja e saj me krimin e organizuar dhe narko-trafikun, pastrimi i parave, krijimi i strukturave oligarkike arbitrarë që imponojnë politikat publike dhe vakumi në sundimin e ligjit e kanë shndërruar Shqipërinë në një pjesë të mafies ndërkombëtare, që do të sundojë e shfrytëzojë ekonominë shqiptare dhe resurset e saj. Mungesa e sundimit të ligjit dhe dobësitë e agjencive për zbatimin e tij si dhe ngadalësimi i ngritjes dhe funksionalizimit të institucioneve të reja të drejtësisë e kanë zëvendësuar sundimin e ligjit në Shqipëri me sundimin e krimit, pastrimit të parave, oligarkisë arbitrarë dhe mafies ndërkombëtare. Ngritja e alarmit për sundimin e ligjit nga presidenti Meta është një kauzë e vërtetë publike dhe kombëtare për Shqipërinë dhe Shqiptarët.

3. Mbrojtja e lirive e të drejtave të njeriut

Demokracia është, para së gjithash, sistem i lirisë dhe të drejtave të njeriut. Nga shkalla e ekzistencës së lirisë dhe të drejtave të njeriut varet demokracia dhe zhvillimi i saj në të gjitha fushat. Tranzicioni i stërzgatur shqiptar është reflektuar më së shumti në

Deçani, pjesë e projektit të USAID-it 'Komunat transparente, efektive dhe llogaridhënëse'

DEÇAN, 27 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka pritur në takim pune Jeton Canën, ekspert për qeverisje lokale dhe administratë publike në USAID, Afërdita Mekulin, drejtoreshë e projektit të USAID-it, dhe Agim Salihun, zëvendës drejtor i projektit të USAID-it "Komunat transparente efektive dhe llogaridhënëse (TEAM)" si dhe Cristina Davisin, drejtoreshë e

Zyrës për demokraci dhe qeverisje në USAID.

Gjatë këtij takimi të përbashkët ata e kanë njoftuar kryetarin Ramosaj se aktiviteti i USAID-it "Komunat transparente, efektive dhe llogaridhënëse në Kosovë" përkrah përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve qeveritare dhe agjencive të pavarura të Kosovës për ta forcuar llogaridhënien dhe efektivitetin në prokurimin publik, si një mjet



për përmirësimin e shërbimeve publike dhe rritjen e besimit të publikut, veçanërisht në nivel komunal. "Duke punuar ngushtë me partnerët komunalë dhe duke mbështetur

lidhjet me qeverinë qendrore, agjencitë e pavarura dhe shoqërinë civile, promovon ndryshimet lokale duke krijuar ndikim të qëndrueshëm. Për këtë qëllim objektivat dhe fushëveprimi i programit, ku objektivat kryesore të programit janë: zhvillimi, përsosja dhe aplikimi i modeleve për komuna transparente dhe llogaridhënëse, angazhimi i nivelit qendror në trajtimin e efektivitetit dhe

transparencës komunale në kuadër të procesit të prokurimit dhe përmirësimi i monitorimit dhe mbikëqyrjes nga shoqëria civile", ka njoftuar Komuna e Deçanit.

Sipas këtij njoftimi, Ramosaj, duke falënderuar zyrtarët e projektit të USAID-it, që edhe komuna e Deçanit të jetë pjesë e këtij projekti, ka nënshkruar letërzotimin për të qenë partner, përkatësisht komunë në fokus në këtë projekt.

mangësitë, cenimin dhe shkeljen e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Vitet e fundit, sidomos mbas reformës kushtetuese për sistemin e ri të drejtësisë, dimensionin i lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri ka njohur përkeqësime në disa fusha.

Mazhoranca dhe qeveria aktuale me sjelljen e tyre autokrate dhe me një sërë ligjesh arbitrare kanë cenuar, kufizuar dhe shkelur një sërë lirish e të drejtash themelore të njeriut. Kështu është cenuar seriozisht liria e mendimit, e shprehjes dhe e medias, që përbëjnë liri themelore demokratike. Presidenti i Republikës nuk i ka dekretuar këto lloj ligjesh, por mazhoranca i ka futur në fuqi me të drejtën e saj procedurale dhe në mungesë të Gjykatës Kushtetuese.

Në tre vjetët e fundit është konstatuar nga brenda dhe nga raportet ndërkombëtare cenimi i lirive politike, në mënyrë të veçantë liria e votës, pra e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në mënyrë demokratike, pluraliste, përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Në zgjedhjet politike të 2017-s dhe në zgjedhjet lokale të 2019-s u konstatuan parregullsi të mëdha dhe vepra penale, siç janë shitblerja e votës, shantazhimi i votuesve, shpërdorimi i policisë dhe administratës publike, manipulimi i kontrollit të mediave, abuzimet financiare etj. Shtetet demokratike të BE-së, ShBA-së organizatat relevante ndërqeveritare dhe joqeveritare, mediat prestigjioze ndërkombëtare kanë evidentuar këto shkelje të të drejtave politike në Shqipëri.

Për këto parregullsi e shkelje edhe presidenti Meta ka ngritur zërin publikisht brenda dhe jashtë vendit. Si rezultat i këtij informimi dhe komunikimi me evidenca u demaskuan raste e figura konkrete dhe u përpiluan dosje të veçanta të krimit elektoral në Shqipëri. Faktorë ndërkombëtarë, si Bundestagu Gjerman, i kanë kërkuar Shqipërisë t'i nisë proceset hetimore mbi krimin elektoral, sikundër OSBE/ODIHR ka kërkuar një reformë të thellë elektorale në Shqipëri për garantimin e zgjedhjeve

demokratike pluraliste, të lira dhe të ndershme. Ngritja e zërit nga presidenti Meta për zgjedhje demokratike, pluraliste, të lira dhe të ndershme, është një kauzë e vërtetë publike dhe kombëtare për Shqipërinë dhe shqiptarët.

4. Mbrojtja e popullsisë së Shqipërisë dhe territorit të Kosovës

Akumulimi dhe tejzgjatja e krizës politike dhe institucionale në Shqipëri ka ndikuar në përkeqësimin e treguesve të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit. Rënia ekonomike, mungesa e investimeve të huaja direkte, përkeqësimi i lirisë ekonomike dhe të biznesit kanë rritur numrin e papunësisë, sidomos te rinia dhe te shtresat më të kualifikuara në vend. Kjo krizë komplekse ka provokuar largime masive të të rinjve dhe të një sërë profesionesh që kërkojnë në tregjet e huaja dhe për të cilët ka nevojë edhe Shqipëria.

Braktisja e vendit ka arritur shifra alarmante. Largimi i rinisë po sjell pakësimin fuqisë punëtore dhe plakjen e popullsisë së vendit. Ndërsa largimi i shtresave të kualifikuara, sidomos në shëndetësi, inxhinieri dhe sektorë të tjerë të rëndësishëm po ul burimet e kapaciteteve intelektuale të vendit. Përmasat e kësaj 'patalogjie' sociale po japin pasoja të drejtpërdrejta, por me efekte edhe afatgjata në të gjitha fushat.

Nga shteti dhe qeveria nuk ka ndonjë reagim konkret, të studiuar mirë, nuk po formulohen strategji politikash publike, ndërtimi institucionesh dhe kërkime burimesh financiare për ta stimuluar qëndrimin e rinisë dhe të kapaciteteve njerëzore brenda vendit. Përkundrazi. Kohët e fundit dëgjohen deklarata tymnajë për hapjen e Shqipërisë për fuqi punëtore të huaj nga vende të pazhvilluara apo nga zona krizash. Pra, po shkohet kështu drejt ndryshimeve demografike me pasoja të paparashikueshme për identitetin kombëtar të vendit.

Ndërsa Shqipëria po shpopullohet dhe mendohet të popullohet me të ardhur, në Kosovë kohët e fundit është lansuar teza skajshmërisht e

rrëzishme për shpëputjen e Veriut të saj, duke përfshirë territore, popullsi, burime natyrore dhe ujore të konsiderueshme për fatet e Kosovës. Një tezë e tillë i bie ndesh Kushtetutës së Shtetit të Kosovës, interesave të saj si dhe krijon një precedent të rëndë për paqen, sigurinë dhe stabilitetin rajonal.

Pra, në të dyja anët e kombit shqiptar po luhen politika që për pasojë sjellin dobësimin e tij. Presidenti Meta në mënyrë të vazhdueshme dhe publike ka ngritur zërin për të parandaluar këto dy politika anti-shqiptare, shpopullimin e Shqipërisë dhe cenimin e integritetit territorial të Kosovës. Ai, gjithashtu, ka drejtuar gishtin edhe drejt atyre faktorëve politikë, gjeopolitikë, mafiozë dhe agjenturorë që qëndrojnë prapa këtyre dy sfidave anti-shqiptare. Kauza e presidentit Meta për ta mbrojtur popullsinë e Shqipërisë dhe integritetin territorial të Kosovës është një kauzë e vërtetë kombëtare që meriton mbështetjen e fuqishme të shqiptarëve nga Shqipëria, Kosova dhe mbarë bota.

Data e 2-marsit 2020 po afron. Është data kur presidenti Meta ka thirrur popullin shqiptar në një tubim për mbrojtjen e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sundimit të ligjit, lirive dhe të drejtave të njeriut, mbrojtjen e popullsisë së vendit dhe integritetit territorial të Kosovës. Është e para herë që në vendin tonë presidenti i Republikës i drejtohet popullit drejtpërdrejt në një manifestim publik. Natyrisht, presidenti e gëzon të drejtën e komunikimit me qytetarët e vendit të vet. Madje, për vetë statusin kushtetues, si garantues i unitetit të popullit, presidenti Meta ka plotësisht të drejtën për të komunikuar me qytetarët e vendit dhe mbarë shqiptarët në Ballkan dhe në Botë në të gjitha format demokratike, duke përfshirë edhe tubimet e drejtpërdrejta popullore. Mbi të gjitha, kauzat e ngritura nga presidenti Meta meritojnë plotësisht mbështetje të gjerë qytetare dhe kombëtare. Është koha për ndryshime të mëdha. Presidenti Meta po u prin këtyre ndryshimeve. Ja përse shqiptarët kudo që janë do ta mbështesin.

'Kalabria' në Prishtinë bëhet me çerdhe moderne

PRISTINË, 27 SHKURT (ER) - Komuna e Prishtinës ka përfunduar çerdhen "Cicërimat" në lagjen "Kalabria", investim i Bashkimit Evropian (BE).

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka deklaruar se të hënën kjo çerdhe do t'i ketë 85 fëmijë, kurse kapaciteti i saj është për 120 fëmijë.

Ahmeti ka bërë me dije se çerdhja e radhës me BE-në është në lagjen Dardania, pastaj vetëm komuna do t'i hapë çerdhet edhe në lagjen Arbëria dhe Kolovicë. "Edhe një çerdhe e mrekullueshme në komunë. Të hënën do t'i kemi 85 fëmijë e kapacitet për 120 fëmijë, në një hapësirë 1 000 metra katrorë. Intervenimi në fëmijërinë e hershme është intervenimi më i rëndësishëm që mund të bëjmë. Çerdhja ka kushtuar mbi 600 mijë euro. Çerdhja e radhës me Komisionin Evropian është në Dardani, me kapacitet 100 fëmijë. Derisa si komunë do t'i kemi çerdhet në Arbëri dhe Kolovicë", ka thënë Ahmeti.

Ndërsa zëvendësministri i Arsimit, Jusuf Thaçi, ka theksuar se do të ndryshohet plani legjislativ, ku do të ketë rritje të buxhetit për arsimin. "Falënderojmë BE-në për këtë donacion. Uroj prindërit e



kësaj lagje që t'i edukojnë fëmijët e tyre në këtë kopsht. Kemi paraparë që në planin legjislativ të futet në ndryshim ligji me udhëzime administrative. Kemi bërë përpjekje për ta rritë buxhetin në nivel vendi. Do ta adresojmë edhe çështjen në komunitet. Dhe çështje private ku ndodhin skandale dhe nuk janë të evidentuar fare në Komunën e Prishtinës", ka thënë ai. Në anën tjetër përfaqësuesi i BE-së, Luigi Brusa, ka thënë se besojnë në generatën e re të Kosovës. "Është një projekt për të ardhmen e Kosovës, fëmijët e Kosovës. Ne besojmë në Kosovën dhe në generatën e re që të sjellë një perspektivë të re. 85 fëmijë mund të jenë pjesë e kësaj çerdhe dhe 22 edukatorë mund të punojnë këtu. Ftoj komunën dhe organet kompetente që të kujdesen për të ardhmen. 50 milionë euro kemi ndihmuar në edukimin pasi ne besojmë në Kosovën", ka thënë Brusa.

Fillon zbatimi i punimeve restauruese-konservuese në shtëpinë e familjes Koci

PRIZREN, 27 SHKURT (ER) - Pas vlerësimeve të bëra nga zyrtarë të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren, kanë filluar të zbatohen punimet për ndërhyrje restauruese-konservuese në shtëpinë e familjes Koci. Kjo ndërtesë gjendet brenda Qendrës Historike të Prizrenit, respektivisht në lagjen e Potokmahalles të qytetit të Prizrenit. Bazuar në stilin arkitektonik, teknikës dhe materialit të ndërtimit, monumenti në fjalë konsiderohet të jetë ndërtuar në shekullin XIX dhe iu përket shtëpive me zgjidhje të veçantë, e cila ka shërbyer dhe akoma shërben për banim. Formësimi hapësinor, proporcionet, organizimi i brendshëm, elementet e



enterierit, trajtimi i fasadës me elemente dhe daljet në formë erkëri paraqesin tiparet kryesore artistike të kësaj ndërtese. Në kuadër të parcelës së familjes Koci gjenden shtëpia, oborri dhe nyja sanitare. Kjo ndërtesë i është nënshtruar procesit të restaurimit dhe konservimit në kuadër të zbatimit të programit, masat preventive - intervenimet emergjente, financuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Begaj viziton qendrat shëndetësore në Malishevë

Malishevë, 27 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Liridon Hoti, i kanë vizituar disa prej qendrave dhe punkteve shëndetësore në fshatrat e Komunës së Malishevës. Ata janë njoftuar nga personeli shëndetësor me shërbimet që janë duke ofruar, sidomos në këto ditë të gripit sezonal e që si rrjedhojë edhe numri i pacien-

tëve është më i madh.

Begaj dhe Hoti i kanë vizituar qendrat shëndetësore në Bellanicë, Kërvasari, Dragobil, Panorc, Drenoc dhe Llazicë, ku janë takuar me personelin shëndetësor dhe pacientët e rastit dhe kanë biseduar me ta për ofrimin e shërbimeve në këto qendra dhe punkte shëndetësore. Sipas personelit shëndetësor, këto ditë numri i pacientëve është më i madh për shkak të gripit sezonal, ndërsa shërbimet janë duke iu

ofruar të gjithë atyre që kanë nevojë, ndërsa edhe kushtet e punës janë të mira.

Po ashtu, punëtorët shëndetësorë dhe qytetarët kanë paraqitur kërkesë për shqyrtimin e mundësisë për rritjen e shërbimeve shëndetësore, përkatësisht rritjen e numrit të mjekëve. Për këtë kërkesë dhe nevojë, kryetari Begaj tha se "së bashku me udhëheqjen e QKMF-së dhe drejtorinë komunale do t'i shqyrtojnë të gjitha mundësitë për



këtë çështje, në mënyrë që edhe shërbimi të jetë më afër qytetarit, por edhe të lehtësohet puna në QKMF në Malishevë, edhe pse

pacientët nuk kanë barnatore nëpër fshatra, por së paku të sëmurët ta kenë shërbimin më afër".

Ligjvënësit kritikojnë Pentagonin lidhur me buxhetin për mbrojtjen

UASHINGTON, 27 SHKURT - Ligjvënësit amerikanë kritikuan të mërkurën vendimin e Pentagonit për t'i zhvendosur rreth 4 miliardë dollarë nga buxheti i mbrojtjes, për të financuar ndërtimin e murit në kufi me Meksikën. Ata thanë se ky veprim është një anashkalim i autoritetit të Kongresit dhe mund të ndikojë në aftësinë e ushtrisë për të riprogramuar fonde në të ardhmen.

Në fillim të këtij muaji, Pentagoni tha se do t'i përdorë 3.8 miliardë dollarë nga buxheti për ushtrinë për të financuar murin, një premtime kryesor i fushatës së

Trumpit katër vjet më parë si dhe në garën e këtij viti. Vendimi i Pentagonit u prit me shqetësim nga ligjvënësit e të dyja palëve gjatë një seance dëgjimore mbi buxhetin në Kongres me Sekretarin e Mbrojtjes Mark Esper dhe shefin e Shtatmadhorisë, Gjeneral Mark Milley.

Administrata e presidentit Trump ka premtuar të ndërtojë rreth 640 kilometra mur përgjatë kufirit me Meksikën deri më nëntor 2020. Në fushatën e tij për vitin 2016, Trumpi tha se për ndërtimin e murit do të paguante Meksika, por qeveria e këtij

vendi ka refuzuar në mënyrë të vazhdueshme ta bëjë këtë gjë.

“E mbështes çështjen e ndërtimit të murit, por jam thellësisht i shqetësuar se ku po shkojmë lidhur me çështjet kushtetuese, mbi rolin e Kongresit në mbrojtjen kombëtare dhe nëse ky autoritet po tejkalohet”, tha ligjvënësi Mac Thornberry, republikani kryesor në komisionin e forcave të armatosura të Dhomës së Përfaqësuesve. Ligjvënësi Adam Smith, kryetari i komisionit, e cilësoi vendimin e Pentagonit si “tejet të dëmshëm”.

Në një letër e cila mban datën



25 shkurt ligjvënësit Smith dhe Thornberry shkruanin se ata e kishin mohuar kërkesën e Pentagonit për t'i zhvendosur

paratë, duke nënvizuar shqetësimin mbi përdorimin e buxhetit të mbrojtjes për të financuar ndërtimin e murit.

Varhelyi: Integrimi i Ballkanit Perëndimor, prioritet i Komisionit Evropian

BRUKSEL, 27 SHKURT - Komisionari për Zgjerim i Bashkimit Evropian, Oliver Varhelyi ka thënë se Komisioni Evropian e ka prioritet integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.

“Është në interesin strategjik të BE-së që ky rajon të jetë pjesë e BE-së”, ka thënë Varhelyi në takimin e ministrave të jashtëm të vendeve anëtare të Grupit të Vishegradit me homologët e vendeve të Ballkanit Perëndimor – Kosova, Serbia, Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut.

Grupin e Vishegradit e përbëjnë: Çekia, Sllovakia, Polonia dhe Hungaria.

Ministri i Jashtëm i Çekisë, Tomas Petříček, si kryesues i Grupit të Vishegradit tha se zgjerimi i BE-së është mënyra më e mirë për të pasur stabilitet në Ballkanin Perëndimor dhe BE. Ai konfirmoi mbështetjen e Grupit të Vishegradit për hapjen e bisedimeve me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, ka njoftuar rfe.

“Ne do të bëjmë çmos për të bindur edhe vendin e fundit që tregon hezitim. Në veçanti, Varhelyi ka punuar me vendet që hezitojnë të kapërcejnë pengesat dhe shpresojnë për rezultatin pozitiv në samitin e marsit”, tha Patriček.

Megjithatë, i pyetur nga “Radio Evropa e Lirë”, nëse ekzistojnë garancitë nga Franca dhe



Holanda se në muajin mars do të japin dritën jeshile për nisjen e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, komisionari për Zgjerim, Oliver Varhelyi tha se “nuk ka garanci të forta në politikë”, megjithatë ai tha se mbështetet në raportin e përparimit të këtyre dy vendeve dhe se shpreson që kjo do të merret në konsideratë dhe do t'i bindë dy shtetet anëtare që nuk mbështesin hapjen e negociatave.

Në emër të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në takimin e

mbajtur në Pragë, foli ministri i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut, Nikola Dimitrov, i cili tha se procesi i integrimit të rajonit në BE nuk është vetëm një përpjekje e qeverive të Ballkanit Perëndimor, por edhe e shoqërive të këtyre vendeve.

“Unë po flas në emër të Ballkanit Perëndimor, vendeve që janë të rrethuara nga vendet anëtare të BE-së. Pjesa më e madhe e ekonomisë sonë është pjesë e ekonomisë evropiane gjithashtu”, tha Dimitrov.

Shefi i diplomacisë maqedonase

falënderoi presidencën çeke të Grupit të Vishegradit për përparësinë dhe ndihmën për të mbajtur lartë në prioritetin e BE-së çështjen e zgjerimit.

Ai gjithashtu tha se vendet në rajonin e Ballkanit Perëndimor janë të bashkuara për një të ardhme të përbashkët evropiane.

“Liberalizimi i vizave për Kosovën është i mirë për të gjithë rajonin, përparimi për Bosnjë dhe Hercegovinë është gjithashtu i rëndësishëm. Ne ende kemi disa dallime në rajon, por ne po

punojmë dhe duam t'i zgjidhim ato, por ajo që na bashkon të gjithëve është e ardhmja jonë e përbashkët evropiane”, tha Dimitrov.

Vendet e Vishegradit përmes Fondit Ndërkombëtar të Vishegradit nënshkruan memorandum mirëkuptimi me Fondin e Ballkanit Perëndimor, përmes së cilit këto vende vazhdojnë ndihmën për procesin e integrimit të këtyre vendeve duke ofruar asistencë teknike me fokus në ngritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile në këto vende.

Maas: Sulmet kundër civilëve në Idlib janë krime lufte

NYU JORK, 27 SHKURT - Ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Maas, deklaroi të enjten se sulmet kundër civilëve në Idlib janë krime lufte.

Gjatë një takimi të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Maas deklaroi se Qeveria siriane dhe aleatja e saj

Rusia, kanë detyrim për t'i mbrojtur civilët, por përkundrazi, po bombardojnë infrastrukturën civile, si spitale dhe shkolla.

Sipas OKB-së, rreth 950.000 persona janë zhvendosur në veriperëndim të Sirisë që nga dhjetori, për shkak të një

fushate të vazhdueshme të Qeverisë siriane në qëndresën e fundit të rebelëve.

Gjithashtu Maas i kërkoi Këshillit të Sigurimit, të sigurojë hyrje të plotë humanitare në vendin e shkatërruar nga lufta, duke shtuar se ndihma ndërkuftare është me rëndësi jetike.



Një autore që hedh hapin suksesshëm në letërsinë për fëmijë

(Fragmente nga shënimet për shkrimtaren Dritë Ruhani dhe kolanën e saj prej 12 librash)

Prof. As. Dr. Astrit BISHQEMI

Subjekti... kompozicioni

E tërë kolana është një korpus prozash të shkurtra artistike për fëmijë me një gjetje të këndshme “tregime për gjumë të ëmbël”. Kjo bashkësi copëzash kësisoj, e parë nga larg, formon një mozaik të bukur letrar.

Fragmentarizmi sfumohet pa të rënë fort në sy.

Secili vëllim më tepër ka formën e një tollumbaci, të cilën mund ta fryje ende. E pra, secili vëllim ka formën e një antologjie me tematikë të caktuar.

Autorja e ka lënë numërimin me aq ditë sa ka muaji referues (pjesa e parë vendoset në muajin janar, e dyta – në shkurt e me radhë). E gjithë kolana është konceptuar me 12 libra, sa muaj ka viti. Lexuesit, – prindi qoftë, i afërm tjetër i familjes, mësuesja a vetë fëmija – i serviret një tregim për çdo natë. Kësisoj, çdo vëllim i ngjan më tepër një novele a romani; ndonjëri madje një reportazhi që përshkruan një udhëtim nëpër Shqipëri.

Veçori e përbashkët kompozicionale e librave të Dritë Ruhanit është se ata e ndërtojnë veprimin mbi dy linja karakteristike: atë të njerëzve dhe atë të kafshëve (qenve). Këto dy linja herë ecin paralelisht, herë mbizotëron njëra e herë tjetra, herë kryqëzohen, përplasen a bashkohen e udhëtojnë së bashku. I gjithë libri i tretë, për shembull, është fantastik. Ngjarja a veprimi pothuajse zhvillohet ndërmjet qenve. Në pjesën e nëntë “O vendi im!”, veçori është se mbizotëron linja njerëzore. Qysh në kreun e parë “Rilindje”, kemi zotëri Dimalin që mban në duar fotografinë e Marës dhe mediton me vete rreth saj...

Në kërkim të së resë

E lexojmë kolanën e librave të zonjës Ruhani dhe në fund i shtrojmë vetes pyetjen: Cila është e reja që sjell kjo autore në letërsinë shqipe për fëmijë e të rinj?

Së pari mendja na shkon te sasia, te bashkësia prej 12 copë librash, të cilat i lidhin personazhet e njëjta. Jo, letërsia jonë shqipe për fëmijë, këndeje e andej kufirit të shtetit shqiptar, njeh shkrimtarë që kanë botuar të tilla kolana. Mos ndoshta e reja qëndron te tematika, jeta e qenve? Nuk besojmë. Tregime mbi jetën e qenve kanë shkruar e botuar autorë që nga Naim Frashëri e këtej. Atëherë?

Mendimi ynë është se e reja që sjell Dritë Ruhani me kolanën e saj për qentë qëndron jo vetëm në trajtimin e një teme aq gjërë e aq thekshëm, por edhe në idetë që sjell kjo shkrimtare.

Madje, është një problem i madh shoqëror. Autorja bën kryepersonazhë qentë endacakë në Prishtinë, por edhe në Tiranë ku

gjendja paraqitet ende më keq.

Zgjidhet shpirti gazetaresk

Si ish-gazetare, autorja edhe në pozitën e saj të re si shkrimtare, na ngre me guxim një sërë problemesh shoqërore të tjera në këtë kolanë librash. Veçse tani (në romane e jo më nëpër gazeta) ato mvishen me petk letrar. Si më të nxehtin do të vlerësonim atë të fesë (vëllimi V), veprimin e disa shoqatave humanitare të rrejtshme, siç është ajo që ndihmon familje të tëra me ushqim, me kusht që të shtojë numrin e besimtarëve myslimanë. Këtë problem tani autorja e trajton të mveshur me petk artistik, me një rast konkret. Tregon për një familje në nevojë, ku vajzës Arbëresha, i kërkojnë që të braktisë shkollën e mesme të arsimit të përgjithshëm, të mbulohet e të vazhdojë medresen...

Edhe gjetkë, gratë besimtare të mbuluar, autorja i sheh vrëngër, me sy jo të mirë. Diku njëres prej tyre sikur ia ndyn pak mantelin një qenushë-nënë, tek mbarte e gjora këlyshin e saj të pajetë, dhe gruaja i kthehet kafshës me mallkimin: “Oh Zot, plasëshi!”

Autorja qorton edhe ndonjë gazetar të huaj për reportazhin e tij të realizuar në Kosovë: “*Emisionet e huaja çdo herë e tregojnë qytetin tonë përmes fotove me xhamia, sikur të ishte ndonjë qytet nga shtetet arabe.*” (IV, 64)

Në kolanën letrare gëlojnë edhe një tufë problemesh të tjera shoqërore bashkëkohore, si:

– Herë pas here, në detaje të veçanta, na rikujtohet Kosova heroike me luftën e saj qëndrestare. – Futet edhe lufta në Siri, ku kanë marrë pjesë disa kosovarë dhe pasojat e rënda të saj. Autorja e quan “luftë e kotë” dhe vë gishtin te traumat e saj me një rast konkret: për të shpëtuar, vajza personazhe vetëplagoset.

Nuk mungojnë në kolanë probleme të politikës shqiptare:

– Ngacmohet problemi i partive, i pasurimit të disa njerëzve nga ato.

– Tek trajtohet çështja e gardhit që duhet hequr midis dy fqinjëve, autorja gjuan më larg, aludon për kufirin ndarës të dy shteteve të kombit shqiptar, “murit tonë të Berlinit”.

Kemi pastaj probleme të jetës shoqërore:

– “*Gratë nuk mund të trashëgojnë! Meshkujt janë gllabërues të pronave.*”

– Shitblerja e fëmijëve.

Nuk mungojnë probleme të qytetit:

– Pastërtia e mjedisit.

– Rastet ku biznesmenë a fabrikantë të korruptuar sjellin nga jashtë ushqime të skaduara dhe ua ndërrojnë etiketat...

– ...në tërë qytetin nuk kemi asnjë këshillimore për sjelljen e qenve.

Më tej, nuk harrohen edhe probleme të fshatit:

– Fshatarët nuk kanë treg për shitjen e prodhimeve të tyre



bujqësore e blegtorale, të cilat u shkojnë dëm... Etj. etj. Dora e gazetares duket edhe në episode të tjera, p.sh, kur rrëfen që në kishën e qytetit Velbert të Gjermanisë prifti gjerman kishte organizuar një meshë kushtuar Kosovës...

A nuk dëshmojnë tërë këta shembuj, e të tjerë që nuk i përmendëm, për shpirtin me të vërtetë luftarak qytetar të autores Dritë Ruhani?

Vektori i përparuar shkencor

Konstatojmë me kënaqësi që gjeografia e krijimeve është bukur e gjerë. Diku direkt, diku indirekt, veprimi i tregimeve vendoset në vende të njohura e të shkelura, të përjetuara nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda secilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjerë.

Si anë pozitive të kolanës mund të shënojmë se lexuesi përfiton njohuri nga gjeografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rrethinave të saj) edhe për Tiranën, Elbasanin, për qytetin e Kukësit (të vjetër e të ri), për Krujën, për Durrësin, për Shkëmbin e Kavajës, Sarandën, Gjirokastrën, Butrintin etj. Nuk mungojnë njohuritë për luftërat e Skënderbeut kundër pushtuesve osmanë dhe për historinë e Shqipërisë në përgjithësi.

Por gjithsesi, më dominuese në kolanë janë dijenitë për botën e kafshëve, sidomos të qenve. Qysh në çastin kur autorja merr e na tregon për kafshët (qentë në rastin tonë), e ka siguruar një pjesë të suksesit për veprën e saj.

Dhe vlerësojmë se autorja ka dijeni të gjëra shkencore për botën e kafshëve, të shpendëve e të kandrave në përgjithësi (kujtojmë macet, bletët etj.) dhe atë të qenve në veçanti. Në të gjithë kolanën veprojnë si personazhe një bashkësi e tërë qensh të rracave të ndryshme: Koko, Agena, Pastori, Bulldogu, familja Haski, Mjalta, Loçkushi, Syrrushi, Liza, Goldi, Lala e të tjerë e të tjerë. Dhe për secilin jepen cilësi të veçanta trashëguese të tyre.

Vektori i vlerë artistik

Pohojmë që në krye të radhës se shkrimtarja ka stil të rrjedhshëm dhe të përshtatshëm për lexuesit fëmijë. Pozitiv është fakti që autorja është kujdesur tejet që mos t'i përsërisë të dhënat. Mendimi ynë është se këta libra u adresohen, në radhë të parë,

gruplexuesve të shkollarëve të vegjël, klasa I-V të shkollës sonë nëntëvjeçare. Por, këto krijime letrare për fëmijë tërheqin edhe lexuesit e moshës së rritur. Por çka i bën të ngritura artistikisht këto tekste? Cili është vektori artistik i tyre?

Së pari, vlerësojmë që ai vektor përbëhet nga dukuria e personifikimit. Kjo është vlerë artistike e gjithë kolanës. Dihet që letërsia për fëmijë e ka për zemër animizimin dhe personifikimin e sendeve, të kafshëve e të shpendëve etj. Këtu u jepet shpirt, gjallërohen, animizohen; u jepet edhe logjikë, pra personifikohen, sende të ndryshme: herë varka e herë lulet. Mbretëresha e luleve, Trandafili i bardhë, bisedon me lulet e tjera, të cilat i sheh nga lartësia. Gjerësisht autorja ka personifikuar qentë.

Së treti, mendojmë që vlerë të veçantë artistike në kolanë përbën humori i pranishëm në çdo vëllim. Dihet që humori është shëndeti i një krijimi letrar, sidomos kur ajo vepër u adresohet fëmijëve. Në bashkësinë që shqyrtojmë këtë dukuri kaq të rëndësishme e tërheqëse për lexuesit, e shikojmë të pranishme në disa forma: Kemi humor që buron nga situata: P.sh., nga veprimi i një kumaci:

“– Që të mos shpenzojë të holla për veteriner e mjete të tjera higjienë, natën fsheturazi e ka rruar qenin...”

Rasti tjetër, kur humori buron nga batuta e personazhit. Për shembull: “Shkon një qen në spital dhe e pyet qenushen në informacion: – Më fal, ku merren injeksionet të dielave? – Në prapanicë, si çdo ditë, - i përgjigjet ajo”

Ose:

“Kur një njeriu i kishte ikur qeni, e kishin pyetur: – Pse s’po e jep për humbjen e qenit një lajmërim në gazetë? E ai ishte përgjigjur: – Se qeni im nuk di të lexojë!”

Kemi edhe humor të naivitetit fëmënor:

“– Pse qan, vogëlush? - e pyeti zonja Luljeta.

– Më ka humbur qeni!

– E ku banon ti?

– Nuk e di. Këtë e di vetëm qeni im!

Ky lloj humori në këtë kolanë është i pranishëm edhe nga ana e personazheve qen. P. sh.: Një qen vjen te dera e ambulancës.

“– O sa simpatik! - klithi Morea me ta parë. - Doktor, një bukurosh te dera ka një dhuratë për ju!

– Ha-ha-ha, - u qesh ai. - Ky bukuroshi nuk ka dhuratë për

mua. Gjethi sipas tij është monedhë. Ai vjen çdo ditë, në kohë të njëjtë, për të blerë ushqim tek unë. Më paguan me një gjeth”

Rasti i veçantë është humori anekdotik i pranishëm. Një mori anekdotash tregohen nga ana e Rronit në çdo vëllim të kolanës. Ja: “A e dini që fjala matematikë rrjedh nga shqipja, nga një shqiptar që ka kaluar shumë duke mësuar dhe pastaj ka ikur: mat e mat, mat e mat, mat e mat – ikë”

Këto anekdota jo vetëm që e individualizojnë Rronin si karakter, por e bëjnë tekstin tërheqës për lexuesin fëmijë.

Së fundi, vemë në dukje që përveç humorit, autorja përdor me sukses shumë frazeologji popullore e fjalë të urta, si:

– ... edhe te njeriu më i mirë fshihet një tigër;

– ... ai që mbjell erën, do të korë furtunën;

– Fatit si t’i thërrasish ashtu të përgjigjet;

– Çdo qen ka hijen e vet;

– Kafshata e madhe ta zë fytyr;

– Mos e prek në bisht, se të ha në gisht;

– ... nëse nuk do që muzgut t’i kërkosh lëmoshë, përqafoje mëngjesin me vrull pune;

– Njerëz të tillë, që me gojë të lajnë e me dhëmbë të çajinë...

– Gjuha kocka s’ka, por kocka thyen;

– Fusha ka sy e gardhi ka veshë etj.

Nuk mund të lëmë pa përmendur peizazhet e bukura që përshkruan herë-herë autorja. Ja një i tillë:

“Edhe pse kemi hyrë në pranverë, mëngjesi sot gdhii i mbuluar me borë. (...) Sidomos manushaqet, ashtu me kokën e qitun jashtë, dukeshin sikur po flinin në shtrat të bardhë. Një kombinim shumë i bukur ngjyrash, por disi rrëqethës. Një peizazh me pranverë e dimër në një, që me mëngjes brohoriste: “Jam një pranverë e bardhë, një pranverë e bardhë përrallore!” (IV, 5).

Të gjitha këto dukuri që renditëm padyshim që përbëjnë vlera artistike në pendën e shkrimtares.

Vlerësuam që shkrimtarja vërtet ka stil të rrjedhshëm dhe të përshtatshëm për lexuesin fëmijë. Le t’u gëzohemi pozitiviteteve të padiskutueshme që na ka sjellë shkrimtarja Dritë Ruhani dhe që patjetër e pasurojnë letërsinë tonë shqipe për fëmijë.

Duke përfunduar, shtojmë edhe diçka informative. E pyetëm autoren për tri vëllimet e ardhshme që do të mbyllin kolanën. “Vëllimin e dhjetë mendoj ta titulloj *Qeni i lidhur*, – na shpjegoi ajo, – të njëmbëdhjetin: *Në komë*. Vëllimi i fundit, ndoshta-ndoshta, mund të vërtitet si përmbledhjeve e paraardhësve të tij.”

I urojmë shkrimtares shëndet, vullnet e suksese të mëtejshme për ta shpënë cilësisht deri në fund nismën e saj artistike, nismë e guximshme e jo e lehtë.

E rrallë

Miliona karkaleca “pushtojnë” Bahreinin, shoferët ndalin veturat për t'i “shijuar” pamjet e pazakonta

Një video e pazakontë është filmuar në Bahrein, ku miliona karkaleca pushtuan rrugët dhe shoferët që ishin brenda veturave mbetën të habitur. Miliona karkaleca kishin kaluar nga pjesa lindore e Afrikës për në Kinë, për ta vazhduar rrugëtimin në Lindje të Mesme, Pakistan dhe Indi. Qielli në Bahrein është zakonisht i kthjellët për faktin se shumicën e kohës është mot me diell, por të hënën ka qenë më zyrtë pasi miliona karkaleca fluturuan.



FOTO E DITES



Në New Hampshire në Uashington një antenë shihet e mbuluar me akull. /AP/

E jashtëzakonshme

Shkencëtarët aksidentalisht zbulojnë një qenie që nuk thith oksigjen

Oksigjeni përbën rreth 20 për qind të atmosferës së tokës, proces ky që ndihmon në frymëmarrjen qelizore. Por, siç duket, jo të gjitha qeniet thithin oksigjen. Sipas mediave të huaja, shkencëtarët në Tel Aviv kanë zbuluar një parazit të quajtur “Henneguya salminicola” që,



sipas tyre, është qenia e parë shumëqelizore e gjetur ndonjëherë që në procesin e frymëmarrjes nuk përdor oksigjenin. “Henneguya salminicola” është qenie e vogël e përbërë me vetëm 10 qeliza, që duket pak si një leshterikë, e ngjashme me kandilin e detit.

BARSOLETA E DITËS



- A është origjinal ky mbushës?
- Po.
- E sa kushton?
- 15 euro shok, po për ty 2 euro.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.


Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, **fb: Kino ABC.**

**DASHI**


Kini një kujdes të madh në

punë: sigurohuni që nuk keni bërë gabime në të kaluarën që tani mund t'ju pengojnë.

**DEMI**

Në familje do të duhet të

pranoni që askush nuk është i përsosur dhe që edhe ju ndonjëherë bëni gabime.

**BINJAKËT**

Gjeniu brenda jush do të

zgjohet dhe do t'ju bëjë të zgjidhni në momentin e fundit një situatë, mbase të një natyre financiare.

**GAFORRJA**

Është koha e përshtatshme për të

marrë pak kohë për pushim dhe relaksim. Stimujt e papritur mund ta tërheqin vëmendjen tuaj.

**LUANI**

Me Hënën te Peshqit

nuk mund të thuhet se kjo ditë do të jetë një çudi sentimentale. Prandaj kini kujdes.

**VIRGJËRESHA**

Në familje dhe në marrëdhënien me

partnerin tuaj ju duhet të sqaroni disa gjëra. Ajo që është më e rëndësishme është se marrëdhëniet tuaja me njerëzit janë shumë të forta dhe të palëkundshme.

**PESHORJA**

E vetmja gjë që duhet të

bëni është të vendosni disponueshmërinë! Në punë do të shkojë gjithçka vaj.

**AKREPI**

Shumë probleme dhe situata të pakëndshme mund të zgjidhen falë

këmbënguljes suaj, por edhe falë intuitave të papritura, e në disa raste do të tregoheni si një gjeni i vërtetë.

**SHIGJETARI**

Ditë e bukur dhe e lumtur

nga e cila mund të tërhiqni energji dhe ide për punë dhe për sferën tuaj private.

**BRICJAPI**

Ndoshta do t'ju duhet të mermi

përsipër detyra që nuk ju pëlqejnë, por të domosdoshme për të planifikuar dhe organizuar një punë apo biznes në ditët e ardhshme.

**UJORI**

Energjia dhe pasioni janë

ndërthurur pozitivisht me shpresën për ta goditur objektivin tuaj dhe madje mund të fitoni edhe një çmim.

**PESHQIT**

Sido që të jetë situata, ju keni

hijeshi dhe karizëm, ide dhe imagjinatë të zgjuar, paratë tuaja do t'i shfrytëzoni për disa blerje të zgjuara.


Gati albumi i ri i Lady Gagas



Pas Oskarit dhe provës si aktore me “A star is Born”, Lady Gaga është e gatshme të rikthehet me një album të ri dhe të premten do të ofrojë një shijim të parë të tij me këngën “Stupid Love”. Këtë e ka bërë me dije në

rrjetet sociale vetë ylli i popit, duke publikuar një foto të një reklame të singëllit. Disku i fundit “Joanne” i takon vitit 2016 dhe në këta katër vjet Lady Gaga ka ndryshuar sërish lëkurë si në nivel profesional, po ashtu edhe në atë privat.

Rihanna shfaqet plot stil



Rihanna, një ikonë mode, organizoi një festë me rastin e hapjes së dyqanit të saj të ri Fenty në Bergdorf Goodman, ku i surprizoi të gjithë teksa u shfaq orë përpara hapjes së dyerve. Rihanna u

shfaq e veshur me një fustan të shkurtër portokalli, i çarë paksa në njërin anë. Portokalli ishte edhe ngjyra e pardesysë, ndërsa çizmet saten krijonin kontrast, shkruan “Anabel”.




Rita Ora godet me veshjen

Thuhet se ajo ka kërkuar kohë nga romanca e saj me aktorin Rafferty Law. Megjithatë, Rita Ora i tregoi djalit të Judes se çfarë ka humbur ndërsa ajo u drejtua për darkë në West Hollywood të mërkurën, shkruan “DailyMail”.

Duke guxuar të shkojë pa reçipeta nën veshjen transparente, këngëtarja 29-vjeçare lë pak vend për imagjinatë. Rita siguroi që të gjithë sytë të ishin në të teksa ajo doli jashtë me bluzë të tejdukshme në ngjyrë më të errët.

Laura dhe Ben u bënë prindër sërish



Laura Prepon dhe Ben Foster e kanë mirëpritur fëmijën e tyre të dytë së bashku. Aktorja 39-vjeçare e Orange is the New Black e ka postuar lajmin në “Instagram”, por nuk e ka zbuluar gjininë e foshnjës, ditëlindjen apo

ndonjë informatë tjetër. “Mirë se erdhe në shtëpi paketa jonë e re e dashurisë”, ka shkruar Laura. Çifti e ka edhe një vajzë dyvjeçare së bashku me emrin Ella. Laura dhe Ben janë martuar në qershor të vitit 2018.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Selimi: Prishtina ka përparësi terrenin dhe traditën

Trajneri Musa Selimi ka thënë se ndeshja në mes të Prishtinës dhe Ballkanit do të jetë e jashtëzakonshme dhe nëse fitojnë suharekasit do të jenë shumë afër titullit. “Profa” ka shtuar se Prishtina e ka përparësinë e terrenit dhe traditës. Ndërsa trajneri i trofeshëm, Afrim Toverlani, ka pohuar se, përveç fatit, ndeshja mund të vendoset edhe nga ajo se cila skuadër vendoset më mirë



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 27 SHKURT - Derbi i madh në futbollin e Kosovës do të zhvillohet të shtunën në stadiumin “Fadil Vokrri” në mes të Prishtinës dhe Ballkanit. Kjo ndeshje ka zgjuar interesim të madh dhe pritët që edhe stadiumi të jetë i mbushur me tifozë. Trajneri i njohur në futbollin e Kosovës, Musa Selimi, ka thënë të enjten për “Epokën e re” se kjo përballje do të jetë ndër më interesantet në vitet e fundit për faktin se të dyja këto skuadra janë duke luftuar për titull. “Do të jetë një ndeshje e jashtëzakonshme. Përballen dy klubet që e synojnë titullin në këtë edicion. Ballkani ka treguar formë të mirë dhe nëse e fiton këtë ndeshje, do të jetë edhe më afër qëllimit. Prishtina ka përparësinë e terrenit dhe traditës. E mira e gjithë kësaj është se tifozët do ta kenë rastin të shohin një ndeshje të jashtëzakonshme”, ka thënë Selimi.

Për superpërballjen e se shtunës ka folur edhe një prej trajnerëve më të mirë në vend, Afrim Toverlani. “Toki” për “Olle” ka thënë se fituesin mund ta vendosë se cili ekip vendoset më mirë faktikisht në fushë. “Së pari uroj të mbushet stadiumi dhe të fitoj më i mirë në fushë. Gjithsesi, dy skuadrat kanë mjaft lojtarë cilësorë. Edhe futbollistët në bankën e rezervistëve i kanë të mirë. Mendoj se trajneri i cili do të vendosë se në cilën mënyrë taktike të luajë ndeshjen edhe do ta fitojë, duke mos përjashtuar edhe fatin i cili është i rëndësishëm në të tilla takime”, ka thënë Toverlani. Skuadra e Ballkanit ka njoftuar se është duke i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme teknike dhe sportive për t’u përgatitur sa më mirë për ndeshjen e fundjavës. “Në kuadër të kësaj situatë që bartë një ndeshje derbi FC Ballkani do të dërgojë klubin në karantinë. Klubi vendoset në hotel ‘Emerald’ një

ditë para ndeshjes. Gjithashtu, për media është e paraparë edhe konferenca për shtyp ditën e premte në orën 17:30 në hotel ‘Emerald’”, thuhet në njoftimin e klubit kampion të vjeshtës.

Munishi: Prishtina po tutet

Trajneri i Ballkanit, Ismet Munishi, ka thënë se Prishtina është duke pasur frikë para përballjes me skuadrën lidere të elitës. Përballja në mes të kryeqytetasve dhe skuadrës nga Suhareka zhvillohet të shtunën nga ora 17:00. “Mbasi është një ndeshje e zakonshme, pse po tutni pra? E di që krejt Kosova luteni me hup sepse ne jemi më të mirët dhe kenë shumë frikë nga ne. Pa merak, se të gjithëve ju vjen radha. E pranoj që është në formë të mirë FC Prishtina, por me neve është shumë vështirë. Sepse ne jemi kampionë FC Ballkani”, ka thënë Munishi.

SHKURT

Baumann: Vështirë ta mbajmë Rashicën

Milot Rashica është pjesë e Werder Bremenit, por sulmuesi konsiderohet kandidat i sigurt për shitje për verë. Tashmë klube si Liverpool, RB Leipzig dhe Borussia Dortmund janë vënë pas sulmuesit të Kosovës. Drejtori sportiv i Werder, Frank Baumann, thotë se ende nuk kanë biseduar me klube, por është e vështirë të mbahet një lojtar si Rashica në skuadër. “Ende nuk është marrë asnjë vendim dhe ne ende nuk kemi negociuar me klubet. Është e qartë se lojtarët që kanë treguar diçka në sport do të duan të ndërmarrin hapin tjetër në një moment. Ne duhet të jemi realistë për këtë”, ka thënë Baumann. Rashica nuk ka shënuar në Bundesligë që nga 14 dhjetori.

Rusi operohet me sukses

Futbollisti Gëzim Rusi është operuar me sukses. Lajmin e ka konfirmuar skuadra e Rusit, Trepça '89, nëpërmjet një postimi në “Facebook”. “Qendërsulmuesi ynë Gëzim Rusi pati një intervenim kirurgjik të cilin e kaloi me sukses. Kryesia, stafi i trajnerëve dhe bashkëlojtarët i dëshirojnë shërim sa më të shpejtë dhe rikthim në fushën e blertë”, thuhet në njoftimin e Trepçës '89.

Bayerni e dominon formacionin e javës në Ligën e Kampionëve

Janë zhvilluar katër ndeshje shumë interesante në Ligën e Kampionëve, në fazën e 1/8 së finale. Të martën Napoli dhe Barcelona kanë luajtur barazim 1-1, ndërsa Chelsea është mposhtur 0-3 në shtëpi nga Bayern Muncheni. Dy ndeshje të tjera u zhvilluan të mërkurën, ku Lyon befasoju Juventusin (1-0), ndërsa Manchester City triumfoi 1-2 në ‘Santiago Bernabeu’, kundër Real Madrid. Formacioni i javës: Neuer, Dubois, Marçal, Alaba, Davies, Tousart, Isco, De Bruyne, Gnabry, Mertens, Lewandowski.

Ish-drejtori i Fenerbahçes: Muriqi mund të luajë në Premierë Ligë

Ish-drejtori sportiv i Fenerbahçes, Damien Comolli, ka thënë se Vedat Muriqi mund të luajë në Premierë Ligë. “Muriqi ende ka për të mësuar dhe për t’u zhvilluar, por ai ka luajtur mirë. Ndoshta Muriqi mund të mos luajë për klube si Liverpool e Manchester City, por për skuadrat e tjera po. Nëse shikoni paraqitjen e tij në ndeshjen Angli - Kosovë, Muriqi kishte shmangur mjaft mirë Michael Keane dhe Harry Maguire”, ka thënë Comolli. “Unë e krahasoj atë vazhdimisht me Olivier Giroud dhe atij mund t’i duhet një Arsene Wenger për t’u përmirësuar edhe më shumë. Disa klube të Ligës Premierë po e monitorojnë. Mbi të gjitha, Muriqi ka aftësi të shkëlqyera fizike. Ai mund të vrapojë tërë ditën. Është i përkushtuar dhe mund ta flasë gjuhën angleze mjaft mirë”, ka shtuar Comolli.

Dënohen Drita, Gjilani dhe Ferizaj

Komisioni Disiplinor i Shkallës së Parë në Federatën e Futbollit të Kosovës ka dënuar Dritën, Gjilanin dhe Ferizajn. Skuadra e Dritës është dënuar me 1 000 euro për lëshim në organizimin e ndeshjes kundër Gjilanit, ku është bërë hedhje e shisheve të PVC në fushë gjatë zhvillimit të ndeshjes nga ana e tifozëve të klubit nikoqir. Sikurse Drita, edhe skuadra tjetër gjilanase është dënuar me 1 000 euro, pasi sjelljet e simpatizuesve të klubit nuk kanë qenë sportive gjashtë ndeshjes kundër Dritës ku nuk mungoi hedhja e shisheve të PVC në fushë, tri kanaqeve dhe një shishe qelqi. Më shumë e njëjtë është dënuar edhe Ferizaj. Kjo e fundit mori këtë vendim nga Komisioni Disiplinor si pasojë e asaj që në ndeshjen kundër Feronikelit, persona të paautorizuar në portën e hyrjes për në fushë qëndruan gjatë gjithë ndeshjes ku shfaqen reagime kundërshtuese në vendimet e gjyqtarëve të takimit, njëherësh manifestuan edhe sjellje jospportive duke ofenduar të njëjtit me fjalë fyese.

Trajneri i Vojvodinës: Nuk do ta drejtoja Kosovën as për krejt paratë e botës

VOJVODINË, 27 SHKURT - Trajneri serb Nenad Lalatović insiston se nuk ekzistojnë para në botë që do ta bindnin atë ta udhëheqë ekipin kombëtar të Kosovës. Ai thotë se do të ishte i gatshëm të shkojë në luftë për

Serbinë. “Po e shoh se disa djelmosha po zgjedhin të luajnë për atë ekip (Kosovën), por unë nuk do të punoja kurrë në një ambient të tillë. Nuk mund të isha selektor i Kosovës. Nuk ka para të botës që do të mund

të më bindnin që ta zgjedh bankinën e të ashtuquajturit reprezentacion të Kosovës”, ka thënë Lalatović për mediumin serb “Alo”. “Nesër, nëse Zoti do të donte që të nisë lufta, unë do të shkoja i pari për ta mbrojtur

vendin tim. Nuk ka frikë në këtë punë. Në Serbi më janë lindur fëmijët. Unë jam patriot i madh. Gjithçka do të bëja që unë dhe njerëzit e mi të jetojnë më mirë”, përfundoi trajneri i Vojvodinës.



Rugova: Istogu shkon në Vushtrri për fitore

ISTOG, 27 SHKURT - Istogu, Ferizaj, Prishtina e Vushtrria vlerësohet se do të luftojnë për titull të kampionit në Superligën e Kosovës në hendboll (femrat). Gara këtë edicion është shumë e fortë, ndërsa të gjitha këto katër skuadra kanë gjasa. Vendimtare mund të jenë përballjet në mes të katërshes së madhe.

Derbi i parë i stinorit pranveror do të zhvillohet të shtunën me fillim nga ora 17:30 në palestrën “Jeton Tërstena - Tota” në Vushtrri, në kuadër të javës së 12-të. Do të takohen Vushtrria e Istogu, të cilat në edicionin e kaluar garuan për trofe. Edhe këtë edicion Vushtrria e Istogu kanë pretendimet e tyre. Kampioni aktual, Istogu, është i pari në tabelë me 20 pikë, ndërsa Vushtrria është e katërta me 16 pikë, por ka një ndeshje më pak të luajtur. Vushtrria llogarit në përkrahjen e shikuesve, por istogaset udhëtojnë për fitore. Këtë e ka thënë kapitenia e skuadrës, Albina Rugova. “Istogu është i gatshëm të



paraqitet në këtë ndeshje. Jemi përgatitur shumë mirë, kemi pasur një fazë përgatitore të suksesshme dhe kohë të mjaftueshme. Fatmirësisht, të gjitha lojtarët janë të gatshme”, ka thënë Albina Rugova. “Istogu udhëton për fitore. Me angazhim maksimal shpresoj se do t’ia arrijmë qëllimit. Pres garë të fortë deri në fund të kampionatit. Secila skuadër do të mundohet t’i shfrytëzojë shanset e veta. Kjo e bën garën

për titull më interesante dhe më konkurruese. Vushtrria është një nga tri rivalët tona”, ka deklaruar Rugova. Ajo thotë se Istogu ka skuadër më të përgatitur se në vjeshtë dhe se loja e skuadrës është më kolektive dhe kompakte. Në kuadër të xhiros së tretë Istogu kishte fituar si vendës ndaj Vushtrrisë me rezultat 33:24. Forca e Istogut dhe e Vushtrrisë në pjesën e dytë të kampionatit do të dëshmohet në derbin e së shtunës.

Dallasi mposhti San Antonion, Clippersat përmbysin Phoenixin

SAN ANTONIO, 27 SHKURT - Luka Dončić vazhdon të mahnitë me performancat e tij në NBA. Talenti sloven frymëzoi Dallas Mavericksin në suksesin 103-109 në parketin e San Antonios. Spursit, duke e mbyllur takimin me “triple double”: 26 pikë, 10 asistime dhe plot 14 “rebounde”. Kjo është herë e 13-të në këtë sezon që 21-vjeçari arrin shifra të dyfishta në tre komponentë të lojës. Protagonist në këtë përballje të luajtur në “AT&T Center” të San Antonios ishte edhe Kristaps Porzingis, që rezultoi shënuesi më i mirë me 28 pikë, pa harruar edhe 12 “rebounde” të tij. Për Spurs spikati DeMar DeRozan me 27 pikë, 8 “rebounde” dhe 9 asistime. Los Angeles Clippers arriti ta rikuperojë 10 pikë (diferencën kjo e krijuar në periodën e parë) ndaj Phoenix Sunsit, duke triumfuar në fund 92-102. Nuk mjaftoi për skuadrën nga Arizona një DeAndre Ayton në formë të shkëlqyer, autor i 25 pikëve dhe 17 “reboundeve”. Kalifornianët besuan te lidershipi i Kawhi Leonard, i cili realizoi 24 pikë dhe rikuperoi 14 topa. Pavarësisht mungesës së Kemba Walker,



Boston Celtics koleksionuan suksesin e 41-të sezonal në shtëpinë e Uah Jazz me rezultatin 103-114. Spikati për skuadrën mike me 33 pikë dhe 11 “rebound” Jayson Tatum, duke zhvlerësuar paraqitjen e jashtëzakonshme individuale të Donovan Mitchell, autor i 37 pikëve për Jazz. Në “Toyota Center”, Houston Rockets mendoi për ta dëfryer publikun vendës në përballjen me Memphis Grizzlies, që u dorëzua pa kushte 140-112. 33

pikë për Russel Westbrookun dhe 30 të tjera për James Hardenin, që e patën si shëtitje këtë takim. Mbrëmje për t’u harruar për Grizzliesin, që humbi për dy javë Brandon Clarke për shkak të një dëmtimi në këmbën e djathtë. Disfatë në frymën e fundit për Miami Heat 126-129 kundër Minnesota Timberwolves. Skuadra nga Florida shpërdoroi një epërsi prej 12 pikësh pesë minuta para rënies së sirenës për përfundimin e takimit. Vendimtar koshi i realizuar nga Jordan McLaughlin, që i dha avantazhin Timberwolvesit në minutat e fundit, pa harruar bllokun e D’Angelo Russell (më i miri me 27 pikë) ndaj Jimmy Butler (18 pikë).

REZULTATET		
Charlotte Hornets - New York Knicks	107-101	
Cleveland Cavaliers - Philadelphia 76ers	108-94	
Washington Wizards - Brooklyn Nets	110-106	
Atlanta Hawks - Orlando Magic	120-130	
Miami Heat - Minnesota Timberwolves	126-129	
Houston Rockets - Memphis Grizzlies	140-112	
San Antonio Spurs - Dallas Mavericks	103-109	
Phoenix Suns - Los Angeles Clippers	92-102	
Utah Jazz - Boston Celtics	103-114	

SHKURT

Guardiola: Asgjë nuk ka përfunduar rreth kualifikimit

Manchester City e fitoi përballjen e parë me Real Madridin (1-2) në “Santiago Bernabeu”, por trajneri Pep Guardiola ka thënë se asgjë nuk ka përfunduar sa i përket kualifikimit. “Ne erdhëm për fitore dhe ia dolëm. Por, ka mbaruar vetëm pjesa e parë. Nëse një skuadër është në gjendje të rikthehet nga ky disavantazh, atëherë është Reali. Në fazën kur po luanim më mirë, ne pran-am gol. Më pas, në fazën kur Reali po luante më mirë, ne shënuam gol. Kështu e ka futbollit. E mbaj në mend ndeshjen çerekfinale dy stinorë më parë në ‘Anfield’ kundër Liverpoolit, kur po luanim jashtëzakonisht mirë, por Liverpooli realizoi nga çdo tentim që pati në portë”, ka deklaruar Guardiola.

Ferdinand: Liverpooli është favorit në Ligën e Kampionëve

Ish-futbollisti i Manchester Unitedit dhe Kombëtares së Anglisë, Rio Ferdinand, ka thënë se Liverpooli edhe me tutje është favorit për ta mbrojtur trofeun e Ligës së Kampionëve. “Nuk mund të shoh më larg se Liverpool, nëse jam i sinqertë”, ka thënë Ferdinand. “Unë mendoj se ata do të kalojnë Atletico Madridin. Mendoj se do të jetë një ndeshje e vështirë, por ‘Anfield’ i jep asaj një dimension tjetër. Bayern München dukej shkëlqyeshëm kundër një skuadre që është në kërkim të formës dhe identitetit të tyre në këtë moment. Kështu që ata mund të kenë arritur më të mirën e tyre pak më herët, kush e di, kur shkojnë para ata janë të shkëlqyeshëm, por në mbrojtje, do të shqetësohesha pak për Bayernin. Por, Liverpooli është favori im”, ka deklaruar Ferdinand.

Zidane: Duhet të fitojmë në Manchester

Zinedine Zidane fajëson atë rënie përqendrimi të skuadrës së tij për 10 minuta, e cila solli përmbysjen e rezultatit nga Manchester City, por humbën edhe kapitenin Sergio Ramos. “Bëmë 75 minuta të mira. Jemi të zemëruar me humbjen, por kjo është një ndeshje që zgjat 180 minuta. Tani duhet t’i shohim anët pozitive. Nuk ka shumë të tilla sa i përket rezultatit, por bëmë një ndeshje të mirë, përveç minutave të fundit. Tani duhet të shkojmë atje dhe të fitojmë. Na duheshin vetëm 10 minuta më shumë përqendrim në një ndeshje të vështirë dhe në fund e paguam. Bëmë gabime që na dëmtuan. Kishim nevojë për 90 minuta përqendrim total, veçanërisht ndaj një skuadre si Manchester City. Por kjo është vetëm gjysma e rrugës dhe tani është e thjeshtë, duhet të shkojmë në Manchester dhe të fitojmë”, ka thënë Zidane.

Ja shuma që Fury e kërkon për një duel ndaj Joshuas

John Fury, babai i boksierit britanik Tyson Fury, u shpreh se për një duel ndaj Anthony Joshua djali i tij do të kërkojë një shumë prej 250 milionë dollarësh. Këtë kërkesë Tyson do t’ia paraqesë Eddie Hearn, promotorit të Joshuas. “Nuk do ta shesim veten kaq lirë. Ne e dimë se sa vlen kjo sfidë, se sa vlen Tyson, ndaj do të kërkojmë 250 milionë dollarë për të dueluar me Joshua dhe unikuar titujt kampionë bote në peshën e rëndë”, ka thënë John Fury. Fury, 30 fitore e 1 barazim në karrierë, mori titullin kampion bote në peshën e rëndë në kategorinë WBC pas fitores me “KO teknik” në raundin e shtatë ndaj Deontay Wilder. Ndërkohë që Joshua mban titujt e kategorive IBF, WBA dhe WBO. “Tyson është numri 1 në peshën e rëndë, ndaj ka të drejtë t’i diktojë rregullat për një përballje me Joshuan. Kjo është një përballje që ka shumë të ardhura, ndaj të gjithë duhet të vlerësohen ashtu si duhet. Gjithashtu, ne duam që kjo përballje të zhvillohet në Britaninë e Madhe”, ka shtuar John Fury.



NJOFTIM PER DISKUTIM PUBLIK

Në kuadër të Projektit për Sigurinë e Ujit dhe Mbrojtjen e Kanalit (WSCPP) të financuar nga Banka Botërore, parashihet që të behet rehabilitimi i kanalit ekzistues të sistemit Ibër-Lepenc, ku punët do të zhvillohen në disa seksione të komunave: Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri dhe Obiliq.

Si rrejdhojë para fillimit të punëve parashihet që të prezantohet një Plan i Menaxhimit Mjedisor (PMM) në secilën nga komunat e prekura siç u tha me lartë. Ky dokument jep shpjegime dhe rekomandime për masat që duhet të ndërmerren gjatë kryerjes së punëve, në mënyrë që të ketë sa më pak ndikime mjedisore dhe sociale, ne mjedisin dhe popullatën perreth.

Dokumenti është i përgatitur në dy gjuhë (Shqip dhe Serbisht) mund të shkarkohet nga web faqja <http://www.iber-lepenc.org> si dhe nga web faqet e komunave të prekura nga ky projekt.

Oraret e diskutimeve publike:

03.03.2020, e Martë, ora 11:00, Salla e Kuvendit Komunal- Obiliq

03.03.2020, e Martë, ora 13:30, Salla e Kuvendit Komunal -Vushtrri

04.03.2020, e Mërkurë, ora 10:00, Salla e Kuvendit Komunal-Zubin Potok

04.03.2020, e Mërkurë, ora 14:00, Salla e Kuvendit Komunal-Mitrovicë



OBAVEŠTENJE O JAVNOM RAZGOVORU

U okviru projekta Obezbeđenje vode i zaštita kanala (WSCPP) finansirano od strane Svetske Banke, kojim se predviđa rehabilitacija postojećeg kanala sistema Ibar-Lepenac, radovi će biti sprovedeni u nekoliko opštinskih sekcija kao što su: Zubin Potok, Mitrovica, Vučitrne i Obilić.

U nastavku pre početka sprovođenja radova predviđeno je predstavljati Plan za upravljanje okolinom (PUO) po svakoj unapred navedenoj opštini. Preko ovog dokumenta se daju objašnjenja i preporuke o merama koje će biti preduzete prilikom sprovođenja radova, da bi smo imali što manje uticaja na okolinu i društvo.

Dokumenat je pripremljen na dva jezika (Albanski i Srpski) postoji mogućnost da preuzmete sa Web stranice <http://www.iber-lepenc.org> kao i sa Web stranice dotične opštine gde će biti sproveden ovaj unapred navedeni projekat.

Raspored javnog razgovora:

03.03.2020, Utorak, 11:00 časova, Hala Skupštine Opštine - Obilić

03.03.2020, Utorak, 13:30 časova, Hala Skupštine Opštine -Vučitrne

04.03.2020, Srijeda, 10:00 časova, Hala Skupštine Opštine -Zubin Potok

04.03.2020, Srijeda, 14:00 časova, Hala Skupštine Opštine -Mitrovica



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2019:131640
Datë: 19.02.2020
Numri i dokumentit: 00840458

P.nr.38/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm-gjyqtari i vetëm gjykues Shëfqet Baleci, me pjesëmarrjen e procesmbajtës Elheme Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit Hamit Gurguri nga Fushë Kosova, rruga "Vëllezrit Frashëri" nr.9, për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, të parashikuar nga neni 375 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-Kodi i Vjetër, të cilin sipas autorizimit e mbrojnë Avokat Ymer Osaj dhe Sevdali Zejnullahu, që të dy nga Prishtina, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit të Krimeve të Rënda PP/1.192/2015, datë.23.06.2015, në shqyrtimin gjyqësorë publik, të mbajtur me datë 10.02.2020 dhe me dt.14.02.2020, në prani të Prokurorit të Shtetit Ilirjana Çollaku-Tafa, të autorizuarit të dëmtuarit Avokat Gazmend Halilaj nga Gllogoci, të dëmtuarit Ekrem Bërbatovci, mbrojtësve të pandehurit dhe të pandehurit, ndërsa me dt.18.02.2020 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: Hamit Gurguri, i biri i Ferizit dhe i Salës, mbiemri i saj i vajzërisë Shaljanit, i lindur me dt.01.11.1949 në Godanc, Komuna e Gllogocit, tani e ka vendbanimin në Fushë Kosovë, rruga "Vëllezrit Frashëri" nr.9, me numër personal të letërnjoftimit 1030436136, ka të kryer Fakultetin Juridik, magjistër i shkencave juridike, pensionist, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes të mesme ekonomike. Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pagjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet një procedurë tjetër për veprën penale.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me dt.28.02.2015, rreth orës 13:00, në fshatin Godanc, Komuna e Gllogocit, e ka përdorë armën me qëllim frikësimi, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari Ekrem Bërbatovci, ishte duke hapur vrima për vendosjen e shtyllave të betonit si dhe duke vendosur ato shtylla si rrethojë e oborrit pranë oborrit të shtëpisë së tij, kishte ardhur i pandehuri me veturën e tij, të tipit "Golf 2", me ngjyrë të zezë, dhe pasi që i dëmtuari i ishte afruar të dritarja e veturës së tij, meqë më të njëjtin paraprakisht kishin pasur disa mosmarrëveshje, i pandehuri i është kërcënuar me fjalët "mos mu afro se të vras", duke mbajtur në dorë revolën e tipit 6 (gjashtëqe), me ngjyrë të bardhë, ia ka drejtuar këtë revole të dëmtuarit Ekrem Bërbatovci.

-me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, të parashikuar nga neni 375 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-Kodi i Vjetër.

njëri dënim do të ndikoi që të parandaloi të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarit për dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

7.-Arsyet lidhur me vendimin për paushallin gjyqësorë:

Vendimin mbi paushallin gjyqësorë, gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 par.3. të KPP-së, ashtu që lartësia e paushallit gjyqësorë në shumë prej 50 Euro, u caktua duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës penale si dhe gjendjen financiare të të pandehurit.

8.-Arsyet lidhur me vendimin për takësin gjyqësorë:

Vendimin që të detyrohet i pandehuri që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj takësin në shumë prej 30 Euro, gjykata e bazoi në nenin 39 par.3. nënpar.3.1. të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit (ku është paraparë se gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuar në nënparagrafët 3.1. dhe 3.2. të këtij paragrafi caktojnë edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim: për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në shumë prej tre dhjetë (30) €, i cili ligj me datën.28.05.2015 ka hyrë në fuqi, e për të cilin Gjykata Supreme e Kosovës me Qarkoren nr.35/2018, të dt.30.01.2018, për zbatimin e të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit ka kërkuar nga gjykatat që të zbatojnë këtë dispozitë ligjore për të e paguar takësin e lartëtheksuar.

9.-Arsyet lidhur me kërkesën pasuroro juridike

Vendimin që të dëmtuarin Ekrem (Isa) Bërbatovci nga Godanci, Komuna e Gllogocit, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale të e udhëzoi në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 463 par.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Nga e lartëtheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.38/2019, datë:18.02.2020

Procesmbajtësja
Elheme Kastrati

[Signature]



Gjyqtari
Shëfqet Baleci

[Signature]

KËSHILLË JURIDIKE:Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Në bazë të nenit 380 par.2. të KPP-së, ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar si më lartë, e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnica i Klinicka Sluzba Kosova
Hospital and University Clinical Service of Kosovo



Qendra e Shendetit Mendor - Centar za Mentalno Zdravlje - Mental Helth Center
Shtepit per Integrim ne Bashkesi - Kuce za Integraciju u Zajednici - House for community integration
Peje - Pec

Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, si dhe në mbështetje të Nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Qendra e Shëndetit Mendor në Pejë,shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për pranimin në marrëdhënie pune dhe atë:

Titulli i vendit të punës	Kërkohen:	Koeficienti i pagës
1. Infermier/e të përgjithshëm	2	4.8

Numri i references: /2020
Norma e punës; Orar i plotë
Kohëzgjatja e kontratës; Në kohë të pacaktuar me periudhë provuese 3(tre) mujore
Kushtet për pjesmarrje në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe i plotësojnë kushtet sipas konkursit për vendin e punës për të cilin aplikojnë.

